

PLANI OPERATIV EMERGJENT LOKAL (POEL)

PËR

KOMUNËN E RAHOVECIT

PLANI BAZIK

Shtator 2026

Plani Operativ Emergjent Lokal

Përmbajtja

Dekretimi i Planit Operativ Emergjent Lokal	4
Regjistri i ndryshimeve/freskimi	5
Vërtetimi i rishikimeve	5
Lista e shpërndarjes	5
Hyrje	6
Qëllimi, fushëveprimi, situata dhe supozimet në komunën e Rahovecit	6
Koncepti i operimit\veprimit	26
Organizimi dhe caktimi i përgjegjësive	28
Menaxheri i Qendrës Operative Emergjente (QOE)	30
Zyrtari për Informim Publik (ZIP)	31
Komunikimi	32
Zjarrfikja	32
Kërkimi dhe Shpëtimi	32
Shëndetësia/mjekësia	32
Reagimi për naftë dhe materiale të rrezikshme	33
Siguria Publike	33
Spektori i planifikimit	34
Menaxhimi emergjent	34
Spektori i Logjistikës	34
Transporti	35
Punët publike dhe të inxhinierisë	35
Kujdesi masiv, strehimi dhe shërbimet humane	35
Dega e mbështetjes me burime	35
Dega e Burimeve Bujqësore dhe Natyrore	36
Dega e energjisë	36
Rimëkëmbja e komunitetit dhe zbutja	37
Koncepti i operacioneve	37
Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit	45
Komunikimi	45
Administrata, Financat dhe Logjistika	46
Zhvillimi dhe mirëmbajtja e planit	47
Kërkesat për plan, mirëmbajtja dhe shpërndarja	50

Plani Operativ Emergjent Lokal

Shtojca 1 – Fjalori i termave kryesorë

Shtojca 2 – Lista e shkurtesave

Shtojca 3 – Autoriteti dhe referencat

Shtojca 4 – Matrica e përgjegjësi

Shtojca 5 – Bartja e autoritetit

Shtojca 6 – Zhvendosja e qeverisë komunale

Shtojca 7 – Lista e shpërndarjes së POEL

Shtojca 8 – Dokumentet esenciale

Shtojca 9 – Strehim emergjent i popullsisë

Shtojca 10 – Kapacitetet e Njesisë së Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

Shtojca 11 – Resurset emergjente dhe shëndetësore në komunën e Rahovecit

Shtojca 12 – Kapacitetet e Degës së Kryqit të Kuq të Kosovës në Rahovec

Shtojca 13 – Shembull i vendimit për shpalljen-*dekretimin*

Shtojca 14 – Shembull i shpalljes së kërkesës për shpalljen e gjendjes emergjente

Plani Operativ Emergjent Lokal
Dekretimi i Planit Operativ Emergjent Lokal

D E K R E T

Me autoritetin tim të dhënë dhe në bazë të Ligjit mbi Qeverisjen Lokale dhe nenit 91, pika 1.2, të Ligjit Nr. 04/L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, si Kryetar i Komunës së Rahovecit, me autoritetin përfundimtar për menaxhimin emergjent në Komunë, unë shpall Planin Operativ Emergjent Lokal ("Planin 001") të Komunës.

POEL për Komunën e Rahovecit ofron reagimin ndaj emergjencave dhe fatkeqësive me qëllim të shpëtimit të jetëve, të mbrojtjes së shëndetit publik, të sigurisë dhe të mirave materiale, të restaurimit të shërbimeve esenciale, si dhe për të mundësuar dhe asistuar në rimëkëmbjen ekonomike.

Në bazë të nenit 46, pika 2, të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, POEL është në pajtim me Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave në Republikën e Kosovës, Planin e Vlerësimit të Rrezikut për Komunën e Rahovecit dhe në harmoni me Planin e Reagimit Kombëtar.

Drejtori Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim ose Koordinatori\Zyrtari i Menaxhimit Emergjent i Komunës së Rahovecit është përgjegjës për aktivizimin e Qendrës Operative Emergjente (QOE), me qëllim të drejtimit të operacioneve emergjente komunale.

Për më tepër, Koordinatori\Zyrtari i Menaxhimit Emergjent i Komunës gjithashtu është i autorizuar që, në koordinim me Kryetarin e Komunës, në bazë të nenit 47 të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, ta plotësojë/amendamentojë planin, sipas nevojës, për ofrimin dhe krijimin e sigurisë dhe shëndetit të vazhdueshëm të banorëve dhe të mirave materiale të komunës.

Sipas planit, kryesuesi i secilës drejtori, sektor të Komunës, do të caktojë nga një udhëheqës dhe së paku nga një zëvendës për drejtorinë, sektorin përkatës.

Ky dekret hyn në fuqi me nënshkrimin e tij dhe mbetet në fuqi të plotë derisa të amendamentohet apo të shfuqizohet nga dekretet e tjera.

Kryetari i Komunës së Rahovecit


Smajl Latifi



Data 7.9.2026

Plani Operativ Emergjent Lokal

Regjistri i ndryshimeve/freskimi

Të gjitha plotësimet e këtij dokumenti duhet të përcillen. Ky seksion duhet të përfshijë një lloj formati për të bërë një gjë të tillë. Së paku duhet të përmbajë: datën e ndryshimit, faqen apo seksionin e ndryshuar, emrin dhe titullin e personit që ka bërë ndryshimin.

# Ndryshimi	Data	Pjesa e prekur	Data e postimit	Postuesi

Vërtetimi i rishikimeve

Rishikimi i rregullt (4-vjeçar) i këtij Plani Operativ Emergjent Lokal duhet të bëhet nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim. Ky rishikim duhet të vërtetohet përmes drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Data	Nënshkrimi

Lista e shpërndarjes

Pranuesit e kopjes së këtij plani:

Kopja	Organizata	Pranimi individual i kopjes	Data

Plani Operativ Emergjent Lokal

Hyrje

Ky dokument është Plan Operativ Emergjent Lokal i Komunës së Rahovecit. Kriza dhe emergjenca mund të ndodhin në çdo kohë dhe mund të godasin një person, një ndërtesë të vetme apo tërë komunitetin. Emergjencat shkaktojnë konfuzion dhe stres për të gjithë të përfshirët në të. Në mënyrë që të minimizohen këto efekte, aktivizimi dhe implementimi fillestar i Planit të Reagimit Emergjent duhet të bëhet në mënyrë të qetë dhe të qëndrueshme. Implementimi efikas i planit do të ofrojë drejtim të qartë, përgjegjësi dhe vijimësi të kontrollit, për zyrtarët kryesorë dhe administratorët. Ideja themelore e çdo plani të reagimit emergjent të ndërtuar mirë është minimizimi i rreziqeve të mundshme ndaj individëve dhe të mirave materiale gjatë një emergjence. Me qëllim të zvogëlimit të rrezikut të një emergjence, duhet të bëhen vlerësime dhe përmirësime sipas nevojës të planit emergjent.

Qëllimi, fushëveprimi, situata dhe supozimet në komunën e Rahovecit

1. Qëllimi

Plani Operativ Emergjent Lokal (POEL) i Komunës së Rahovecit nxirret në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera dhe aktet nënligjore përkatëse, si dokument themelor për planifikimin dhe organizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në territorin e komunës së Rahovecit.

Plani Operativ Emergjent Lokal (POEL) i Komunës së Rahovecit mbështetet në Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera të Komunës së Rahovecit, i cili identifikon rreziqet natyrore, njerëzore dhe teknologjike që mund të ndodhin brenda territorit të komunës së Rahovecit.

Qëllimi i këtij plani është të përcaktojë sistemin e organizimit, drejtimit dhe koordinimit të aktiviteteve për parandalimin, zvogëlimin dhe zbutjen e rrezikut, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

POEL përcakton:

- Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave në nivel komunal;
- Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve komunale dhe subjekteve të tjera relevante;
- Procedurat operacionale për aktivizimin, mobilizimin dhe bashkërendimin e resurseve;
- Masat për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të qytetarëve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit;
- Masat për rikthimin e funksionimit normal të institucioneve dhe jetës në komunitet pas përfundimit të situatës emergjente.

Ky plan shërben si dokument obligativ për të gjitha strukturat komunale dhe subjektet e përfshira në sistemin e mbrojtjes nga fatkeqësitë, duke siguruar veprim të koordinuar, efikas dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Fushëveprimi

Ky plan është i detyrueshëm për të gjitha institucionet dhe subjektet e përfshira në menaxhimin e emergjencave në territorin e komunës së Rahovecit:

- Organet komunale dhe drejtoritë përkatëse;
- Shërbimet e emergjencës (policia, zjarrfikësit, shërbimet emergjente mjekësore);
- Institucionet shëndetësore dhe arsimore;
- Ndërmarrjet publike dhe operatorët e infrastrukturës kritike;
- Sektorin privat dhe organizatat joqeveritare;
- Vullnetarët dhe strukturat mbështetëse të komunitetit.

POEL përfshin të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave, me theks të veçantë në reagimin operativ dhe koordinimin e burimeve. Ai përfshin:

Plani Operativ Emergjent Lokal

- Mekanizmat e alarmimit, njoftimit dhe informimit publik;
- Aktivizimin e shtabit komunal për menaxhimin e emergjencave;
- Mobilizimin dhe dislokimin e resurseve lokale, si dhe kërkesën për mbështetje rajonale/qendrore;
- Koordinimin horizontal (ndërmjet institucioneve komunale) dhe vertikal (me nivelin qendror);
- Sigurinë dhe shëndetin e personelit të angazhuar;
- Organizimin e funksioneve mbështetëse emergjente (FME).

Konceptet kryesore

Konceptet kryesore që pasqyrohen në tërësinë e këtij plani janë:

- a. Menaxhimi sistematik dhe i koordinuar i incidenteve, i cili përfshin protokollet për:
 - Veprim të koordinuar ndërmjet të gjitha strukturave dhe institucioneve përgjegjëse;
 - Alarmim, njoftim dhe shkëmbim të shpejtë të informacionit ndërmjet aktorëve relevantë;
 - Mobilizim të resurseve lokale, rajonale dhe plotësimin e kapaciteteve të komunës me mbështetje shtesë;
 - Operim efektiv në rrethana të kërcënimeve të ndryshme dhe niveleve të ndryshme të kërcënimit, dhe
 - Integrimin e funksioneve të menaxhimit të krizës dhe pasojave.
- b. Njoftimi dhe dislokimi proaktiv i resurseve në reagim ndaj ngjarjeve shkatërruese në bashkëveprim me të gjitha subjektet sa herë që është e mundur.
- c. Organizimi i përpjekjeve ndërinstitucionale për minimizimin e dëmeve, rikthimin e zonave të prekura në gjendjen e paraincidentit nëse është e mundur dhe/ose zbatimin e programeve për zbutjen e cenueshmërisë ndaj ngjarjeve të ardhshme.
- d. Koordinimi i sigurisë dhe shëndetit të punonjësve, përfshirjes së sektorit privat dhe aktiviteteve tjera që janë të zakonshme për shumicën e incidenteve.
- e. Organizimi i FME-ve për lehtësimin e shpërndarjes së resurseve, aseteve dhe asistencës kritike. Subjektet përkatëse janë ngarkuar për të udhëhequr ose mbështetur FME-të në bazë të autoritetit, resurseve dhe kapaciteteve të tyre.
- f. Sigurimi i mekanizmave për koordinim vertikal dhe horizontal, komunikim dhe shkëmbim të informacionit në reagim ndaj kërcënimeve ose incidenteve. Këta mekanizma lehtësojnë koordinimin midis subjekteve komunale dhe strukturave rajonale, si dhe midis sektorit publik dhe privat.
- g. Hartimi i planeve dhe procedurave plotësuese të detajuara operative, taktike dhe specifike sipas llojit të rrezikut.
- h. Sigurimi i bazës për planifikim, trajnim, ushtrime, vlerësim dhe shkëmbim të informacionit ndërkomunal.

Ky plan synon të sigurojë një qasje të unifikuar, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për përgatitjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe zvogëlimin e rrezikut nga incidentet dhe emergjencat e ndryshme

Plani Operativ Emergjent Lokal

Elementet e planit

Plani Operativ Emergjent Lokal përbëhet nga plani bazik, shtojcat, anekset e Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME) dhe anekse të tjera.

Plani bazik përshkruan qasjen e Komunës së Rahovecit ndaj reagimit dhe menaxhimit të emergjencave, duke përcaktuar politikat, organizimin dhe përgjegjësitë e institucioneve gjatë situatave emergjente.

Shtojcat përmbajnë definicionet e termave dhe shkurtesave të përdorura në plan, si dhe elemente mbështetëse si skica, tabela dhe forma operative.

Anekset e funksioneve mbështetëse emergjente trajtojnë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë dhe veprimet operative të institucioneve për realizimin e funksioneve emergjente, ndërsa anekset për incidente specifike adresojnë nevojat shtesë të planifikimit dhe reagimit për skenarë të veçantë emergjentë.

3. Përshkrimi i situatës

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën jugperëndimore të Republikës së Kosovës dhe karakterizohet nga një territor i përzier fushor dhe kodrinor-malor, me vendbanime urbane dhe rurale të shpërndara në disa fshatra. Pozita gjeografike, kushtet klimatike kontinentale dhe zhvillimi ekonomik i bazuar kryesisht në bujqësi, veçanërisht në vreshtari dhe prodhimtari bujqësorë, ndikojnë drejtpërdrejt në profilin e rrezikut të komunës.

3.1. Karakteristikat

a. Shtrirja

Rahoveci është qytet dhe komunë që shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Kosovës.

Komuna e Rahovecit ka një sipërfaqe prej afërsisht 275.89 km². Territori i saj ndodhet në hemisferën veriore dhe shtrihet ndërmjet:

42°30' dhe 42°50' gjerësi gjeografike veriore;

20°21' dhe 20°55' gjatësi gjeografike lindore.

Komuna e Rahovecit shtrihet rreth 60 km larg Prishtinës (distanca rrugore), në jugperëndim të kryeqytetit.

Komuna e Rahovecit kufizohet:

- në veri me komunën e Klinës (rreth 40 km);
- në verilindje me komunën e Malishevës (rreth 16 km);
- në lindje me komunën e Suharekës (rreth 17 km);
- në juglindje me komunën e Mamushës (rreth 15 km);
- në jug me komunën e Prizrenit (rreth 25 km);
- në perëndim me komunën e Gjakovës (rreth 22 km).

Plani Operativ Emergjent Lokal

Harta 1. Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit



Sipas statistikave të vitit 2024 (ASK), Komuna e Rahovecit ka rreth 41,799 banorë, prej të cilëve:

- 13,642 banorë në zonën urbane (qytet);
- 28,157 banorë në zonat rurale (fshatra).

Shtirja gjeografike e territorit paraqet karakteristika të ndryshme fizike dhe rreziqe të veçanta natyrore. Pjesa verilindore është kryesisht kodrinore dhe e pyllëzuar, duke qenë e ekspozuar ndaj rrezikut nga zjarret. Në anën jugperëndimore, territori është më i ulët dhe shtrihet përgjatë lumit Drini i Bardhë, çka e bën këtë zonë të cenueshme ndaj përmbytjeve. Zona urbane është e dendur dhe me pjerrësi të ndryshme të terrenit, me rrezik nga vërshimet dhe zjarret. Gjithashtu, pozita gjeografike ndërmjet komunave fqinje dhe struktura e përzier urbane-rurale ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik e bujqësor, si dhe në profilin e rrezikut të komunës në kuadër të planifikimit emergjent.

b. Gjeografia


- Komuna e Rahovecit ka një sipërfaqe prej rreth **275.89 km²**. Vendbanimet janë të përqendruara në lartësi mbidetare që variojnë nga **310 m** (pjesa e re e Krushës së Madhe, pranë bregut lindor të lumit **Drini i Bardhë**) deri në **1,038 m** (në majën e bjeshkës së fshati **Zatriqi**). Kjo larmi e lartësive ka ndikim të drejtpërdrejtë në klimën lokale, rrjedhjen e ujërave dhe menaxhimin e emergjencave natyrore.

Rrjeti hidrografik

- Në territorin e Komunës së Rahovecit, lumi më i madh është **Drini i Bardhë**, i cili përbën ujëmbledhësin kryesor të degëve dhe të përroskave të zonës. Lumi nuk buron brenda territorit të komunës, por rrjedh për rreth 30 km nëpër territorin e saj dhe në disa segmente shërben si kufi natyror me komunat përreth (Prizren, Gjakovë, Malishevë dhe Klinë).

Plani Operativ Emergjent Lokal

Harta 2. Rrjeti hidrografik në komunën e Rahovecit



- Lumenjtë dhe përroskat kryesore të komunës së Rahovecit që derdhen në Drinin e Bardhë janë:
Lumi Drinas – degë kryesore që shkon drejt Drinit të Bardhë;
Lumi Rimmik – kalon nëpër territorin e Rahovecit, bashkohet me degë të tjera dhe pastaj derdhet në Drinin e Bardhë;
Lumi Polluzha (Polluzhë) – Lumë që bashkohet drejtpërdrejt me Drinin e Bardhë;
Lumi Bellaja - në këtë lumë bashkohen degët e lumit Duhlllo dhe të lumit të Sopniqit;
Lumi Hoça – buron në fshatin Hoçë e Madhe, merr degë të vogla dhe më pas derdhet në Drinin e Bardhë.
- Lumenjë, përroskat dhe degët e tjera të rëndësishme:
Lumi Duhlllo – formohet nga burime të ndryshme brenda Rahovecit dhe bashkohet me degë të tjera para derdhjes në Drinin e Bardhë;
Lumi Sopniq – buron nga zonat malore të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nushpall dhe bashkohet me degë të tjera para derdhjes në Drinin e Bardhë.

• Burimet ujore të tjera

Në territorin e komunës ka një numër të burimeve dhe përroskave të vogla, të cilat kontribuojnë në rrjetin hidrografik dhe në furnizimin me ujë sipërfaqësor. Disa nga zonat kryesore ku ndodhen këto burime janë: **Zatriq, Koznik, Rahovec, Hoçë e Madhe, Zoqisht, Optrushë, Drenoc** dhe fshatra të tjera.

Këto rrjedha përbëjnë potencial të konsiderueshëm për rrezik nga vërshimet gjatë reshjeve intensive dhe kërkojnë monitorim të vazhdueshëm.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Reshjet mesatare në Rrafshin e Dukagjinit për vitet 2015-2023									
Reshjet mesatare për vit, 2015-2023	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Rrafshi i Dukagjinit	683.9	948.7	701.1	663.3	696.9	654.9	906.9	730.2	830.4

Liqeni i Radoniqit


Liqeni i Radoniqit, megjithëse nuk ndodhet brenda territorit administrativ të komunës së Rahovecit, mund të ketë ndikim të konsiderueshëm.

Në rast të tërmeteve të forta ose të dëmtimeve të strukturës së digës, ekziston mundësia teorike e çarjes/dëmtimit të digës së liqenit.

Një ngjarje e tillë mund të shkaktojë pasoja të rënda për disa zona të komunës së Rahovecit.

Zonat që potencialisht mund të preken nga përmbytjet, janë fshatrat: Dibidol, Dejnë, Ratkoc, Gegjë, pjesërisht Çifllaku, Xërxa, Fortesa dhe Krusha e Madhe.

Harta 3. Rrjedha e Radoniqit në k. E Rahovecit në rast të shpërthimi të digës së Radoniqit.



Megjithatë, duhet theksuar se **Liqeni i Radoniqit** monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet përgjegjëse. Kontrolli teknik i digës realizohet:

- Monitorim i përditshëm i parametrave teknikë;
- Kontroll teknik më i detajuar çdo 3 deri në 6 muaj;

Plani Operativ Emergjent Lokal

- Inspektim i plotë vjetor me raport teknik;
- Auditim strukturor dhe gjeoteknik çdo 3–5 vjet.

Këto masa të kontrollit dhe të monitorimit kontribuojnë në uljen e ndjeshme të rrezikut të mundshëm nga kjo infrastrukturë ujore.

Në rast nevojë për evakuim të banorëve nga zonat e rrezikuara, do të përdoren këto rrugë evakuimi: rruga Sarosh - Polluzhë - Drenoc – Rahovec; rruga Ratkoc - Bratotin - Drenoc – Rahovec; rruga Ratkoc (nga vreshtat) - Sopniq - Fortesë – Rahovec; rruga fushore Malësi e Vogël - Sopniq - Fortesë – Rahovec; rruga Malësi e Vogël - Gexhë - Xërxë - Rahovec.

Rrjeti rrugor në komunën e Rahovecit përbëhet si më poshtë:

Rrugë nacionale: M9.1 Gjakovë - Prishtinë;

Rrugë regjionale: R107 Prizren - Gjakovë;

Rrugë regjionale: R111 Xërxë – Ratkoc - Kramovik;

Rrugë regjionale: R117 Rahovec - Suharekë;

Rrugë regjionale: R204 Rahovec - Krushë e Madhe;

Rrugë regjionale: R110 Malishevë – Rahovec - Xërxë;


Rrugë Urbane: Janë rrugët e lagjeve të qytetit;

Rrugë lokale: Janë rrugët që lidhin të gjitha vendbanimet e komunës;

Rrugë të pakategorizuara: Janë të gjitha rrugët që shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera.

Janë 34 zona kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet e vendbanimeve.

Harta 4. Rrjeti i rrugëve në komunën e Rahovecit



Plani Operativ Emergjent Lokal

Gjatësitë e rrugëve brenda komunës së Rahovecit janë:

Kategoria e rrugës	Gjatësia totale (km)	% nga rrjeti i përgjithshëm
Rrugë nacionale	6.2 km	1.0%
Rrugë regjionale	64.4 km	10.4 %
Rrugë urbane	184.25 km	29.9 %
Rrugë lokale	188.67 km	30.6 %
Rrugë të pakategorizuara	172.68 km	28.1 %
TOTALI	616.2 km	100%

Rrugë nacionale: Kalon nëpër territorin e komunës së Rahovecit, rrugë e rëndësishme në nivel nacional, e cila lidh Prishtinën, Gjakovën dhe Shqipërinë e Veriut (nëpërmjet qafës së Morinës), që cilësohet si rrugë nacionale.

Rrugë regjionale: Rrugët e kësaj kategorie i mundësojnë komunës së Rahovecit lidhje shumë të mirë në nivel regjional dhe kanë shtrirje në pesë drejtime.

Rrugë urbane: Rrugët të cilat lidhin lagjet e qytetit të Rahovecit.

Rrugë lokale: Rrugë të cilat lidhin të gjitha vendbanimet e komunës, duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme të cilat mundësojnë lidhje të mirë me to.

Rrugë të pakategorizuara: janë të gjitha rrugët që shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera.

Hekurudhat: Rrjeti hekurudhor në territorin e komunës së Rahovecit shtrihet në pjesën perëndimore të komunës në një gjatësi prej rreth **30 km**. Hekurudha hyn nga territori i komunës së Klinës, kalon nëpër territorin e Rahovecit dhe vazhdon në drejtim të Prizrenit.

Aktualisht kjo linjë nuk është funksionale për transport hekurudhor brenda territorit të komunës.

Urat në komunikacionin rrugor të komunës së Rahovecit

Nga 57 ura të cilët janë të ndërtuara, 3 prej tyre shtrihen në rrugë nacionale dhe 7 në rrugë regjionale. Urat e tjera shtrihen në rrugë urbane, lokale dhe të pakategorizuara.

Urat në komunikacion hekurudhor

Në rrjetin hekurudhor të komunës së Rahovecit janë të ndërtuara katër ura: një në Marsor, një në Çifllak, një Ratkoc dhe një në Fortesë.

Dy nga këto ura (në Çifllak dhe në Fortesë) kanë seksion të ngushtë, gjë që gjatë reshjeve intensive mund të pengojë rrjedhën normale të ujërave dhe të shkaktojë përmytje lokale në zonat përreth.

Tunelet

Në mes të fshatrave **Gegjë dhe Xërxë** ndodhet një tunel hekurudhor me gjatësi rreth **730 metra**, i cili është pjesë e linjës hekurudhore që kalon nëpër territorin e komunës.

Plani Operativ Emergjent Lokal

c. Demografia

Këto të dhëna janë thelbësore për planifikimin e evakuimit, strehimit emergjent dhe mbështetjen e grupeve të cënueshme gjatë emergjencave.

Për hartimin e kësaj pasqyre demografike janë shfrytëzuar të dhënat zyrtare të publikuara nga **Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)**.

Këto të dhëna ofrojnë informacion të detajuar mbi numrin total të banorëve, shpërndarjen territoriale, përbërjen gjinore dhe karakteristikat e tjera relevante demografike të komunës së Rahovecit.

Në vijim paraqitet analiza e strukturuar e popullsisë përmes tabelave dhe indikatorëve kryesorë demografikë, me qëllim të mundësimin të një interpretimi më të qartë të trendeve demografike dhe implikimeve të tyre në planifikimin emergjent dhe zhvillimin lokal.

Tabela nr. 1. Popullsia e përgjithshme në komunën e Rahovecit për vitet 2011-2024, sipas ASK-së

Viti		Gjithsej	Meshkuj	Femra
2011	Rahovec	56208	28512	27696
2024	Rahovec	41799	20920	20879

Tabela nr. 2. Popullsia sipas vendbanimeve urbane dhe rurale, gjinisë dhe grupmoshës në komunën e Rahovecit për vitin 2024, sipas ASK-së

Rahovec	Popullsia gjithsej	Popullsia meshkuj	Popullsia femra	Foshnje 0 vjeç	Fëmijë 1-6 vjeç	Fëmijë 7-14 vjeç	Popullsia në moshë punë 15-64 Gjithsej	65+
Gjithsej	41 799	20 920	20 879	569	3 459	5 047	8 530	4 539
Urban	13 642	6 996	6 646	214	1 234	1 654	9132	1 408
Rural	28 157	13 924	14 233	355	2 225	3 393	19 053	3 131

Tabela nr. 3. Popullsia sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në komunën e Rahovecit për vitin 2024, sipas ASK-së

		Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Boshnjakë	Turq	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Goranë	Të tjerë	Preferon të mos përgjigjet
Gjithsej	Rahovec	41799	40491	582	9	0	108	323	255	0	18	13
Femra	Rahovec	20879	20234	272	4	0	53	172	125	0	11	8
Meshkuj	Rahovec	20920	20257	310	5	0	55	151	130	0	7	5

Plani Operativ Emergjent Lokal

Tabela nr. 4. Popullsia sipas religjionit në komunën e Rahovecit për vitin 2024, sipas ASK-së							
	Gjithsej	Islam	Ortodoks	Katolik	Të tjerë	Asnjë besim fetar	Preferon të mos përgjigjet
Rahovec	41 799	40 535	573	43	87	35	526

Tabela nr. 5. Popullsia e komunës së Rahovecit sipas vendbanimit dhe gjinisë për vitin 2024, sipas ASK-së								
Vendi	Meshkuj	Femra	Gjithsej		Vendi	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Bellacërkë	769	813	1582		Gexhë	264	239	503
Bërnjak	14	18	32		Hoçë e Madhe	277	231	508
Bratotin	136	129	265		Hoçë e Vogël	494	493	987
Brestoc	328	376	704		Kaznik	58	47	105
Celinë	601	670	1271		Kramovik	404	376	780
Çifllak	561	569	1130		Krushë e Madhe	1601	1582	3183
Dobidol	213	205	418		Mrasor	92	66	158
Dejnë	603	622	1225		Nagac	317	306	623
Drenoc	420	460	880		Nushpall	90	96	186
Pastasel	380	377	757		Opterushë	513	578	1091
Pataçan i Epërm	118	126	244		Sapniq	239	286	525
Pataçan i Ulët	316	356	672		Sarosh	..	..	0
Petkoviq	412	334	746		Senoc	305	280	585
Polluzhë	248	269	517		Vrajakë	281	344	625
Radostë	738	769	1507		Xërxë	1211	1167	2378
Rahovec	6996	6646	13642		Zatriq	94	102	196
Ratkoc	1304	1409	2713		Zoqishtë	207	192	399
Reti e Ulët	92	78	170		Retijë	224	268	492

Plani Operativ Emergjent Lokal

Tabela nr. 6 - Ndërtesat dhe banesat (të banuara dhe të zbrazëta) në komunën e Rahovecit për vitet 2011 - 2024, sipas ASK-së

2021					2024			
	Ndërtesë me së paku një banesë të banueshme të zakonshme	Numri mesatar i banesave për ndërtesë (%)	Numri i banesave të zakonshme	Numri i banesave të zbrazëta	Ndërtesë me së paku një banesë të banueshme të zakonshme	Numri mesatar i banesave për ndërtesë (%)	Numri i banesave të zakonshme	Numri i banesave të zbrazëta
Rahovec	7 691	1.14	8 799	2 448	8 822	1.54	13 547	3 784

Tabela nr. 7. Ekonomitë familjare private sipas statusit të banimit të ekonomisë familjare në komunën e Rahovecit për vitet 2011 dhe 2024, sipas ASK-së

	2011				2024			
	Gjithsej	Në pronësi	Me qira	Forma të tjera të shfrytëzimit	Gjithsej	Në pronësi	Me qira	Forma të tjera të shfrytëzimit
Rahovec	8 210	8 082	73	55	9 169	9 009	100	60

Tabela nr. 8. Ndërtesat sipas llojit të tipit të vendbanimit në komunën e Rahovecit, viti 2024, sipas ASK-së

	Gjithsej	Shtëpi e veçuar, e ndarë në vete	Shtëpi gjysmë e ndarë	Rresht apo varg shtëpish (me të paktën tri banesa të lidhura apo të ngjitura secila me dalje të veçantë jashtë)	Ndërtesë ose blloqe apartamentesh	Tjetër
Rahovec						
Gjithsej	8 641	8 519	75	26	21	0
Urban	2 746	2 669	44	16	17	0
Rural	5 895	5 850	31	10	4	0

Në analizën e trendeve të popullsisë, që mund të ndikojnë në implementimin e planit dhe reagimin emergjent, merret parasysh struktura e moshës së popullsisë.

Sipas të dhënave:

- 10.9% e popullsisë është mbi moshën 65 vjeç (4539 banorë);
- 89.1% është nën moshën 65 vjeç (37,260 banorë).

Nga këto të dhëna vërehet se përqindja e popullsisë nën moshën 65 vjeç është dukshëm më e lartë krahasuar me atë mbi 65 vjeç.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Rrjedhimisht, struktura aktuale e moshës së popullsisë tregon një nivel relativisht të ulët të plakjes demografike, gjë që ndikon pozitivisht në kapacitetet e përgjithshme të reagimit emergjent, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të grupmoshave më të moshuara.

Krahasuar me vitin 2011, komuna e Rahovecit ka shënuar rënie të konsiderueshme të popullsisë. Ky trend lidhet kryesisht me migrimin dhe ndryshimet demografike, të cilat mund të ndikojnë në disponueshmërinë e fuqisë punëtore dhe kapaciteteve lokale për reagim gjatë emergjencave.

d. Zonat e interesit

Zonat e interesit paraqesin hapësira dhe objekte me rëndësi të veçantë për planifikimin, parandalimin, reagimin dhe menaxhimin e emergjencave në territorin e komunës së Rahovecit. Identifikimi dhe klasifikimi i këtyre zonave mundëson vlerësimin më të saktë të rreziqeve dhe përcaktimin e masave prioritare për mbrojtje dhe reagim emergjent.

Këto zona ndahen në kategoritë si vijon:

Zona me rrezik të lartë

Përfshijnë zonat e ekspozuara ndaj përmytjeve, zonat me rrezik të shtuar nga zjarret, si dhe zonat me potencial për rrëshqitje të dheut dhe rreziqe të tjera natyrore ose të shkaktuara nga faktori njerëzor.

Infrastrukturë kritike

Përfshin sistemet dhe objektet esenciale për funksionimin normal të institucioneve dhe shërbimeve publike, si sistemi i furnizimit me ujë, rrjeti i energjisë elektrike, rrjeti rrugor, sistemi i telekomunikacionit dhe infrastruktura tjetër me rëndësi strategjike për reagimin emergjent.

Objekte dhe zona me ndjeshmëri të lartë

Përfshijnë institucionet shëndetësore dhe arsimore, objektet industriale, zonat e grumbullimit publik, objektet e administratës publike, si dhe objektet e trashëgimisë kulturore e historike, të cilat kërkojnë mbrojtje të veçantë gjatë situatave emergjente.

Qëllimi i identifikimit të zonave të interesit

Është sigurimi i një planifikimi më efikas të masave parandaluese, koordinimit institucional dhe reagimit operacional në rast emergjence, me qëllim të mbrojtjes së jetës së qytetarëve, pronës dhe mjedisit.

e. Ngjarjet e veçanta

Në kuadër të Planit Operativ Emergjent Lokal, ngjarjet e veçanta janë aktivitete që karakterizohen nga grumbullime të mëdha të qytetarëve dhe vizitorëve, të cilat kërkojnë planifikim të veçantë, koordinim ndër-institucional dhe zbatim të masave shtesë të sigurisë dhe reagimit emergjent.

Ngjarja kryesore kulturore në komunën e Rahovecit është festivali “**HardhFest**”, i cili gjatë tri ditëve mbledh rreth 60,000 vizitorë.

- **Rreziqet specifike:** Zjarret në hapësira të hapura, incidentet teknike (skenat/pajisjet elektrike), mbingarkesa e komunikacionit, siguria e përgjithshme e qytetarëve dhe nevojat për ndërhyrje të shpejta mjekësore.

Plani Operativ Emergjent Lokal

- **Masat operative:** Ngritja e nivelit të gatishmërisë së Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policia e Kosovës dhe QKMF-ja, vendosja e pikave statike të shërbimeve emergjente në lokacion të festivalit.
- **Festivali Folkorik "Anadrinia Jehon":** Ky festival tradicional organizohet për tri ditë dhe gjatë kësaj periudhe grumbullon afërsisht rreth **5,000 vizitorë**.
- **Rreziqet specifike:** Zjarret në hapësira të hapura përreth aktivitetit, siguria e përgjithshme e qytetarëve, nevoja për ofrimin e ndihmës së parë mjekësore dhe mbingarkesa e komunikacionit.
- **Masat operative:** Angazhimi i Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policisë së Kosovës dhe QKMF-së dhe vendosen pika statike të shërbimeve emergjente në lokacionin e festivalit.

Fluksi sezonal i mërgimtarëve: Gjatë sezonit të verës dhe të dimrit, ardhja e mërgimtarëve rrit ndjeshëm numrin e popullsisë rezidente në komunë.

- **Ndikimi në infrastrukturë dhe shërbime:** Rritje e kërkesës për furnizim me ujë të pijshëm, për energji elektrike, për shërbime shëndetësore dhe administrative.

Rreziqet dhe masat operative:

Rritje e rrezikut për aksidente në komunikacion, shtim i prezencës së Policisë së Kosovës në rrugët kryesore dhe pikat me rrezik të lartë; monitorim i vazhdueshëm i gjendjes së furnizimit me ujë dhe energji elektrike dhe koordinim të vazhdueshëm ndërmjet strukturave komunale.

Të gjitha ngjarjet e lartcekura kërkojnë:

Zbatim të masave shtesë për sigurinë në komunikacion; sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe energji elektrike; ngritjen e nivelit të gatishmërisë së institucioneve përgjegjëse; kapacitete shtesë në QKMF për përballimin e rritjes së kërkesave për shërbime mjekësore dhe koordinim të vazhdueshëm ndërmjet strukturave komunale, Policisë së Kosovës, Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, institucioneve shëndetësore dhe organizatorëve të aktiviteteve.

f. Infrastruktura dhe baza ekonomike

Infrastruktura dhe baza ekonomike e komunës së Rahovecit përbëjnë shtyllat kryesore të zhvillimit dhe funksionimit të qëndrueshëm social-ekonomik të territorit. Ekonomia lokale mbështetet kryesisht në bujqësi dhe vreshtari, me fokus në prodhimin e rrushit dhe verës, ndërsa kantinat e verës dhe përpunimi agro-ushqimor përbëjnë sektorë kyç për të ardhurat dhe punësimin lokal. Paralelisht, zhvillimi i sektorëve të tregtisë, shërbimeve, ndërtimtarisë dhe bizneseve të vogla dhe të mesme kontribuon në rritjen ekonomike dhe në gjenerimin e të hyrave komunale.

Funksionimi i ekonomisë dhe i jetës së përditshme varet drejtpërdrejt nga infrastruktura kritike, përfshirë rrjetin rrugor, furnizimin me energji elektrike, ujësjellësin, kanalizimin, telekomunikacionin etj. Në rast emergjencash ose fatkeqësish natyrore, dëmtimi apo ndërprerja e këtyre sistemeve ndikon menjëherë në prodhim, transport, furnizim dhe në ofrimin e shërbimeve bazë.

Për këtë arsye, prioritet operativ mbetet mbrojtja, mirëmbajtja dhe rikthimi i shpejtë në funksion i infrastrukturës kritike, si dhe siguri i vazhdimësisë së aktiviteteve ekonomike në çdo situatë emergjente.

Plani Operativ Emergjent Lokal


3.2. Profili i rrezikut

a. Rreziqet e mundshme

Bazuar në vlerësimin e rrezikut për komunën e Rahovecit, si dhe në analizën e ngjarjeve emergjente që kanë ndodhur ndër vite në territorin e komunës, janë identifikuar këto kërcënime kryesore që mund të paraqiten në të ardhmen:

- **Reshjet intensive dhe vërshimet** – Reshjet intensive dhe të zgjatura mund të shkaktojnë dalje të lumenjve dhe përrrenjve nga shtrati, dëmtime të rrugëve dhe urave, ndërprerje të furnizimit me ujë dhe energji elektrike, si dhe dëmtime të ekonomive familjare, bizneseve, infrastrukturës publike dhe private, si dhe tokave bujqësore.
- **Zonat më të rrezikuara nga vërshimet janë:** Fortesa, Xërxa, Çifllaku, Gexha, Ratkoci, Malësia e Vogël (Radosta), Sopniqi, Rahoveci, Krusha e Madhe, si dhe pjesërisht Brestoci, Hoça e Vogël, Celina etj.


Harta 5. Zonat e rrezikuara nga vërshimet në komunën e Rahovecit



Plani Operativ Emergjent Lokal

- **Zjarret (pyjore, bujqësore, industriale dhe pompat e derivateve):** Gjatë stinës së verës, por edhe në periudha të tjera, paraqitet rreziku nga zjarret në zona pyjore, zonat urbane, në sipërfaqe të hapura, si dhe në zonat ekonomike (fabrika të ndryshme, pompat e derivateve dhe biznese të ndryshme). Zonat më të rrezikuara gjatë sezonit veror, nga zjarret pyjore dhe fushore, janë: Zatriqi, Drenoci, Kazniku, Senoci, Pastaseli, Guri i Kuq, pjesa verilindore e Rahovecit, Polluzha etj.

Harta 6. Zonat malore dhe fushore në komunën e Rahovecit të rrezikuara nga zjarri



Plani Operativ Emergjent Lokal

- **Tërmetet:** Duke qenë se territori i komunës së Rahovecit konsiderohet zonë me aktivitet sizmik të moderuar, ekziston rreziku i moderuar i dëmtimit të objekteve të banimit dhe infrastrukturës publike dhe private.
- **Rrëshqitje të dheut:** Reshjet intensive dhe përbërja gjeologjike e terrenit në disa zona mund të shkaktojnë bllokim të rrugëve, ndërprerje të furnizimit me ujë, izolim të pjesshëm të vendbanimeve, ndërprerje të energjisë elektrike dhe vështirësi në qarkullim.
- **Epidemitë/pandemitë:** Përhapja e sëmundjeve ngjitëse paraqet rrezik për shëndetin publik dhe mund të ndikojë në funksionimin normal të institucioneve.
- **Incidentet teknologjike dhe materiale të rrezikshme:** Aksidentet rrugore, rrjedhjet e substancave të rrezikshme apo incidentet industriale, mund të kenë pasoja për popullsinë, mjedisin dhe infrastrukturën.
- **Mungesa e energjisë elektrike:** Ndërprerjet e energjisë elektrike, si pasojë e kushteve atmosferike, defekteve teknike apo mbingarkesës së rrjetit, mund të ndikojnë në funksionimin e institucioneve publike, sistemeve të furnizimit me ujë, bizneseve dhe shërbimeve shëndetësore, duke krijuar vështirësi në ofrimin e shërbimeve bazë dhe në menaxhimin e situatave emergjente.
- **Aktet kriminale:** Aktet kriminale, sabotimet, kërcënimet ndaj objekteve publike apo incidente të dhunshme mund të shkaktojnë panik, destabilizim publik dhe ndërprerje të funksionimit normal të institucioneve. Ngjarjet e tilla rrisin nevojën për planifikim të shtuar të sigurisë.
- **Hedhja e mbeturinave të rrezikshme:** Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave dhe ndotja e mjedisit paraqet rrezik për shëndetin publik, tokën bujqësore dhe burimet ujore. Ky fenomen mund të rezultojë në përhapje të ndotjes mjedisore, rritje të rrezikut për sëmundje dhe ndikim negativ në ekonominë lokale dhe në cilësinë e jetës së qytetarëve.

Rreziku natyror	Shkallëzimi i karakteristikave
Shtrëngatë dhe stuhi	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Stuhi	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Mot i ligë	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Zjarr fushor-malor	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Zjarr i madh në objekte industriale dhe prodhuese	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Mungesë e resurseve	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Tërmet	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Vërshim	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Nga faktori njeri	
Terrorizëm	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Aktivitet kriminal	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Vlerësim i rrezikut të brendshëm	Shkallëzimi i karakteristikave
Epidemi, pandemi, endemi	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Epidemi në masë	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Trazirë civile	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Aksident kimik	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë

Plani Operativ Emergjent Lokal

Aksident radiologjik	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Aksident biologjik	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Aksident me eksploziv	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Aksident nuklear	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Dështim i komunikimit	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë
Dështimi i infrastrukturës	I ulët/ i kufizuar/ mesatar/ i lartë

Siç shihet në tabelë, rreziqet që dominojnë sipas **shkallëzimit të karakteristikave**, janë theksuar në ngjyrë të gjelbër. Prandaj, treguesit e rreziqeve dhe vlerësimi i dobësive për ngjarjen e rreziqeve **mesatare dhe të lartë** janë analizuar për **komunën e Rahovecit**. Treguesit e rreziqeve kanë vlerësuar shkallën e rrezikut ndaj të cilëve është e ekspozuar komuna nga rreziqet përkatëse.

Në këtë mund të përfshihet edhe vlerësimi i kapaciteteve ose t'u referohet dokumenteve dhe planeve përkatëse të menaxhimit të emergjencave (vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për komunën e Rahovecit)

b. Vlerësimi i cenueshmërisë

- Cenueshmëria përfshin popullsinë dhe asetet ekonomike, mjedisore dhe infrastrukturore që janë të ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore, teknologjike dhe njerëzore. Ajo ndërlidhet me kapacitetet e institucioneve dhe komunitetit për parandalim, reagim dhe rimëkëmbje në situata emergjente;
- Infrastruktura rrugore paraqet një tjetër element të rëndësishëm të cenueshmërisë. Dëmtimet në rrugët lokale që lidhin fshatrat me qendrën e Rahovecit, sidomos gjatë reshjeve të dendura ose vërshimeve, mund të pengojnë qarkullimin e mallrave dhe ndërhyrjen e shërbimeve emergjente. Për shembull, bllokimi i rrugëve në zonat kodrinore mund të izolojë komunitete dhe të vonojë ndihmën në raste urgjente;
- Shërbimet shëndetësore dhe emergjente gjithashtu përballen me sfida. Kapacitetet e kufizuara të qendrave shëndetësore në zonat rurale dhe distanca nga institucionet më të mëdha shëndetësore rrisin rrezikun për popullatën, veçanërisht gjatë fatkeqësive natyrore apo aksidenteve të mëdha. Ndërprerjet në komunikim (telefonik apo internet) mund të vështirësojnë koordinimin e reagimit emergjent;
- Nga aspekti mjedisor, komuna e Rahovecit është e ekspozuar ndaj thatësirave sezonale, të cilat ndikojnë në burimet ujore dhe prodhimet bujqësore, si dhe ndaj vërshimeve të mundshme gjatë periudhave të ndryshme të vitit në zona të caktuara pranë lumenjve apo përrenjve lokalë. Degradimi i tokës dhe përdorimi i paqëndrueshëm i saj mund të rrisin më tej cenueshmërinë e sektorit bujqësor;
- Objektet dhe shërbimet kritike në komunë përfshijnë rrjetin rrugor, institucionet publike, shkollat, qendrat shëndetësore, shërbimet e sigurisë (policia dhe zjarrfikësit), rrjetet e komunikimit, furnizimin me energji dhe ujë, si dhe subjektet ekonomike lokale, veçanërisht ato të lidhura me agroindustrinë. Çdo dëmtim apo ndërprerje në këto sisteme mund të ketë pasoja zinxhirore për funksionimin normal të komunitetit dhe për rimëkëmbjen pas emergjencave.

Plani Operativ Emergjent Lokal

4. Supozimet

Plani Operativ Emergjent bazohet në një sërë supozimesh themelore që udhëzojnë planifikimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente në Komunën e Rahovecit.

Supozime të përgjithshme

Komuna e Rahovecit është e ekspozuar ndaj rreziqeve natyrore, teknologjike dhe atyre të shkaktuara nga faktori njerëzor, të cilat mund të ndodhin në çdo kohë, shpesh pa paralajmërim të mjaftueshëm.

- Ngjarjet emergjente mund të zhvillohen dhe përshkallëzohen shpejt, duke tejkaluar kapacitetet fillestare të reagimit lokal dhe duke kërkuar mbështetje nga niveli qendror.
- Një ose më shumë rreziqe mund të ndodhin njëkohësisht ose në mënyrë të ndërlidhur, duke rritur kompleksitetin e menaxhimit të situatës.

Supozime mbi rreziqet kryesore në komunën e Rahovecit

- **Përmbytjet/vërshimet:** mund të shkaktohen nga reshje intensive dhe dalja e ujërave nga shtrati i lumenjve, përrënjeve dhe kanaleve të kullimit, duke prekur zonat e banuara dhe tokat bujqësore dhe duke shkaktuar dëme në infrastrukturë dhe ekonomi.
- **Zjarret pyjore, fushore dhe urbane:** paraqesin rrezik të shtuar gjatë sezonit veror për shkak të temperaturave të larta dhe thatësirave, ato mund të ndodhin edhe gjatë gjithë vitit, duke rrezikuar zonat pyjore, bizneset, ekonomitë e ndryshme, pronën, mjedisin dhe në raste të veçanta, jetën e qytetarëve.
- **Thatësirat dhe temperaturat ekstreme:** mund të ndikojnë në furnizimin me ujë (posaçërisht në disa pjesë kodrinore ku nuk ka sistem të ujësjellësit), prodhimin bujqësor dhe shëndetin e popullsisë.
- **Tërmetet:** Vlerësimi i Rrezikut Lokal identifikon tërmetet si rrezik me probabilitet të ulët, por me ndikim të lartë. Supozohet se një tërmet mund të shkaktojë dëme në ndërtesa, si në ndërtesat e vjetra dhe ato të ndërtuara pa standarde të mjaftueshme, për çka mund të kërkojë operacione intensive të kërkim-shpëtimit.
- **Aksidentet me materiale të rrezikshme** (gjatë transportit apo në biznese lokale): mund të rrezikojnë shëndetin publik dhe mjedisin dhe kërkojnë masa të specializuara reagimi.
- **Emergjencat shëndetësore** (p.sh. përhapja e sëmundjeve ngjitëse): mund të mbingarkojnë sistemin shëndetësor lokal dhe të kërkojnë masa të koordinuara ndërinstitucionale.
- **Ndërprerja e infrastrukturës kritike:** Shërbimet kritike si energjia elektrike, furnizimi me ujë, rrjetet e komunikimit dhe infrastruktura rrugore mund të dëmtohen ose të ndërpriten gjatë emergjencave. Ndërprerjet e zgjatura mund të përkeqësojnë ndjeshëm situatën emergjente.
- **Aksidentet rrugore dhe incidentet teknologjike:** mund të shkaktojnë viktima, dëme materiale dhe ndërprerje të përkohshme të qarkullimit dhe të shërbimeve.

Supozime operacionale

- Reagimi fillestar ndaj incidenteve emergjente do të realizohet nga institucionet komunale dhe shërbimet emergjente lokale.
- Menaxhimi i incidenteve do të zhvillohet sipas Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI) dhe në përputhje me SIME-në.
- Qendra Operative Emergjente (QOE 112) do të aktivizohet sipas nevojës për koordinimin e aktiviteteve

Plani Operativ Emergjent Lokal

emergjente.

- Infrastruktura kritike (uji, energjia, rrugë, komunikimi) mund të dëmtohen ose të jenë të kufizuara gjatë emergjencave.

Supozime mbi kapacitetet dhe resurset

- Kapacitetet komunale mund të jenë të kufizuara në raste të incidenteve me përmasa të mëdha ose të zgjatura.
- Në raste të tilla kërkohet mbështetje nga komunat fqinje dhe nga niveli qendror përmes Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (AME).
- Bashkëpunimi me sektorin privat, organizatat joqeveritare dhe strukturat vullnetare është i domosdoshëm për përballimin efektiv të situatave emergjente.

Supozime mbi popullsinë

- Një pjesë e popullsisë mund të kërkojë evakuim, strehim dhe ndihmë humanitare.
- Grupet e cënueshme (të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët) kërkojnë mbështetje të veçantë gjatë emergjencave.

Supozime përfundimtare

- Ky plan bazohet në parimin “të gjitha rreziqet” dhe supozon se strukturat organizative dhe procedurat e përcaktuara janë të zbatueshme për të gjitha llojet e emergjencave, me përshatje sipas natyrës, shkallës dhe ndikimit të incidentit.

Kapacitetet kryesore për reagim emergjent

Kapacitetet komunale janë të parapara edhe në planin e rrezikut për komunën e Rahovecit.

Në kuadër të sistemit të menaxhimit emergjent në komunën e Rahovecit, institucionet publike, shërbimet emergjente dhe subjektet mbështetëse kanë kapacitete të përcaktuara për reagim, ndërhyrje dhe mbështetje gjatë situatave emergjente, si më poshtë:

Shërbimi i zjarrefikjes dhe shpëtimit:

Në kuadër të përgjegjësiave ligjore dhe operacionale, NJPZH:

- shuarjen e zjarreve dhe ndërhyrjen në raste përmbajtës, aksidentesh dhe fatkeqësish të tjera;
- realizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në objekte të dëmtuara dhe zona të përmbytura;
- evakuimin dhe shpëtimin e personave të rrezikuar;
- ofrimin e ndihmës së parë në vendngjarje;
- përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve speciale për ndërhyrje emergjente.

Policia e Kosovës ka kapacitet për:

- sigurimin e rendit dhe të sigurisë publike;
- menaxhimin e trafikut dhe kontrollin e qarkullimit në zonat e prekura;
- sigurimin e perimetrit në zonat e rrezikut;
- mbështetjen në procesin e evakuimit të popullsisë;
- parandalimin e veprave penale gjatë emergjencave;
- bashkëpunimin me institucionet e tjera në menaxhimin e situatave emergjente.

Institucionet shëndetësore (përfshirë qendrat e mjekësisë familjare dhe shërbimet emergjente) kanë kapacitet për:

- ofrimin e ndihmës së parë dhe triazhimin e rasteve emergjente;
- stabilizimin dhe trajtimin e të lënduarve dhe të të prekurve;
- organizimin e transportit emergjent dhe referimin e rasteve në nivele më të larta të kujdesit shëndetësor;

Plani Operativ Emergjent Lokal

- monitorimin dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse;
- ofrimin e mbështetjes psikosociale dhe kujdesit për shëndetin mendor të të prekurve;
- sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të shërbimeve shëndetësore gjatë situatave emergjente.

Drejtoritë komunale dhe shërbimet publike kanë kapacitet për:

- menaxhimin dhe funksionalizimin e infrastrukturës kritike komunale;
- sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve bazë (ujë, kanalizim, energji, pastrim);
- koordinimin e aktiviteteve operacionale në nivel lokal gjatë situatave emergjente;
- ofrimin e mbështetjes logjistike dhe teknike për strukturat e reagimit emergjent.

Ndërmarrjet publike dhe private kanë kapacitet për:

- ofrimin e pajisjeve dhe makinerisë së rëndë (ekskavatorë, kamionë, buldozerë);
- sigurimin e mjeteve të transportit;
- furnizimin me ujë, energji dhe karburant;
- mbështetjen logjistike për pastrimin e rrugëve dhe largimin e materialeve inerte;
- rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar;
- ndihmojnë në krijimin e kushteve për zhvillimin e operacioneve emergjente.

Organizatrat humanitare dhe vullnetarët (Kryqi i Kuq i Kosovës dhe organizatat e tjera relevante) kanë kapacitet për:

- sigurimin e pjesshëm dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare (ushqim, ujë, veshmbathje dhe artikuj higjienikë);
- ofrimin e ndihmës së parë dhe mbështetjes psikosociale;
- ndihmon në menaxhimin dhe funksionalizimin e strehimoreve emergjente;
- regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave për personat e prekur dhe të strehuar;
- mbështetjen në evakuimin dhe asistimin e grupeve të cënueshme.

Kufizimet e kapaciteteve

Megjithatë, bazuar në vlerësimin e rreziqeve në nivel lokal, kapacitetet komunale mund të jenë të kufizuara në rast të incidenteve me përmasa të mëdha ose të zgjatura, veçanërisht në rastet e përmbytjeve të mëdha, zjarreve masive apo emergjencave të kombinuara. Kufizimet lidhen kryesisht me mungesën e pajisjeve të specializuara, kapaciteteve njerëzore dhe burimeve logjistike.

Mbështetja shtesë në raste emergjente

Në rastet e tejkalimit të kapaciteteve komunale, komuna e Rahovecit do të kërkojë mbështetje përmes:

- bashkëpunimit ndërkomunal;
- angazhimit të institucioneve në nivel rajonal dhe qendror;
- mbështetjes nga strukturat shtetërore përkatëse si Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK);
- përfshirjes së sektorit privat dhe organizatave joqeveritare.

Evakuimi dhe strehimi i popullsisë

Gjatë emergjencave, një pjesë e popullsisë mund të ketë nevojë për evakuim, strehim dhe ndihmë humanitare. Vëmendje e veçantë u kushtohet grupeve të cënueshme, përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët.

Evakuimi dhe strehimi realizohet në objekte të përshtatshme publike, si shkolla, qendra sportive, salla sportive që ndodhen nëpër shkolla, si dhe objekte të tjera që plotësojnë kushtet për strehim emergjent.

Menaxhimi i strehimoreve bëhet në bashkëpunim me organizatat humanitare dhe vullnetare, të cilat sigurojnë furnizim me ushqim, ujë dhe veshmbathje, kujdes bazë mjekësor, mbështetje organizative dhe logjistike dhe regjistrimin dhe evidencën e personave të strehuar.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Pas normalizimit të situatës, institucionet përgjegjëse organizojnë kthimin e sigurt të popullsisë në vendbanimet e tyre ose sistemimin e tyre të përkohshëm, nëse kthimi nuk është ende i mundur.

Koncepti i operimit\veprimit

1. I përgjithshëm

- Koncepti i operimit/veprimit përcakton rrjedhën e përgjithshme të reagimit ndaj fatkeqësive dhe situatave emergjente në territorin e komunës së Rahovecit;
- Komunikimi dhe koordinimi mbahen vazhdimisht ndërmjet zonave të prekura dhe Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, e cila siguron shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e veprimeve emergjente;
- Kryetari i Komunës ka autoritetin për të shpallur gjendje emergjente lokale dhe për të kërkuar mbështetje nga niveli qendror. Të gjitha kërkesat për ndihmë qendrore kalojnë përmes Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Qendrës Operative Emergjente (QOE) komunale dhe përcillen te Qendra Operative Emergjente 112 në Prizren, të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent;
- Qendra Operative Emergjente (QOE) komunale shërben si mekanizëm koordinues për operacionet e reagimit dhe rimëkëmbjes, duke menaxhuar dislokimin e resurseve dhe koordinimin e aktiviteteve emergjente në të gjithë territorin e Komunës;
- Veprimet e rimëkëmbjes fillojnë paralelisht me veprimet e reagimit emergjent dhe përfshijnë planifikimin dhe përgatitjen për dislokimin e resurseve të nevojshme. Subjektet mbështetëse dhe organizatat vullnetare përfshihen në plan për të siguruar pjesëmarrjen dhe koordinimin e komunitetit në përballimin e fatkeqësive.

2. Qëllimet dhe objektivat

2.1. Qëllimet

- Promovimi i të gjitha fazave të menaxhimit të emergjencave dhe ofrimi i një reagimi të koordinuar për zbutjen, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, qofshin ato të lokalizuara apo të përhapura;
- Përdorimi efektiv dhe racional i të gjitha resurseve në dispozicion gjatë situatave emergjente;
- Ruajtja e sigurisë dhe e cilësisë së jetës së qytetarëve para, gjatë dhe pas fatkeqësive.

2.2. Objektivat

- **Plotësimi i nevojave të viktimave:** Përfshin shpëtimin e jetëve, trajtimin e të lënduarve, paralajmërimin dhe informimin e publikut, evakuimin e personave të rrezikuar, si dhe koordinimin me institucionet dhe agjencitë për strehim dhe kujdes;
- **Mbrojtja e pronës dhe e mjedisit:** Përfshin parandalimin dhe minimizimin e dëmtimeve të pronës, sigurimin e objekteve, veçanërisht në zonat e evakuuara, si dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit.
- **Rivendosja e komunitetit:** Përfshin rikthimin dhe funksionalizimin e shërbimeve esenciale, rehabilitimin dhe rindërtimin e infrastrukturës dhe objekteve publike, mbështetjen e aktiviteteve ekonomike dhe rikthimin gradual të jetës normale në komunitet.

2.3. Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave – Sistemi i Komandës së Incidentit (SKI)

- Komuna e Rahovecit do të veprojë në parimet e **Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME-2010)** si strukturë standarde për menaxhimin e incidenteve.

Plani Operativ Emergjent Lokal

- Sistemi i Komandës së Incidentit (SKI) përdoret si standard operativ në vendngjarje dhe siguron një strukturë të qartë komandimi dhe koordinimi për reagimin emergjent;
- Qendra Operative Emergjente (QOE) komunale lidhet me vendngjarjen përmes Postës së Komandës së Incidentit (PKI), duke mundësuar monitorimin në kohë reale dhe koordinimin efektiv të operacioneve në terren;
- Reaguesit e parë (policia, zjarrfikësit, shërbimet emergjente shëndetësore) inkurajohen dhe obligohen të zbatojnë SKI-në përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe procedurave standarde operative.

2.4. Vlerësimi dhe kontrolli i rrezikut

- Procesi i menaxhimit të rrezikut përfshin identifikimin, analizimin, kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të rreziqeve, me qëllim të zvogëlimit të ndikimit të tyre në njerëz, pronë dhe mjedis.
- **Perceptimi i rrezikut:** Përfshin identifikimin fillestar të kërcënimeve dhe rreziqeve të mundshme që mund të prekin territorin e komunës dhe popullatën.
- **Vlerësimi i rrezikut:** Përfshin analizimin e probabilitetit të ndodhjes së rreziqeve dhe ndikimit të tyre në aspektin njerëzor, ekonomik, infrastrukturor dhe mjedisor.
- **Përzgjedhja e strategjisë për kontrollin e rrezikut:** Përfshin përcaktimin e prioriteteve dhe zgjedhjen e masave më efektive për parandalimin ose minimizimin e pasojave të rreziqeve.
- **Kontrolli i rrezikut:** Përfshin zbatimin e masave parandaluese, mbrojtëse dhe zbutëse për reduktimin e rrezikut dhe rritjen e sigurisë.
- **Monitorimi i rrezikut:** Përfshin vëzhgimin e vazhdueshëm të situatës, vlerësimin e efektivitetit të masave të ndërmarra dhe përditësimin e planit sipas zhvillimeve dhe rrethanave të reja.

2.5. Përzgjedhja e masave mbrojtëse

Autoritetet komunale dhe QOE përcaktojnë dhe zbatojnë strategjitë për mbrojtjen e qytetarëve dhe pronës, përmes:

- analizimit të rreziqeve dhe identifikimit të zonave të prekura ose potencialisht të rrezikuara;
- përcaktimit të masave mbrojtëse për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës;
- planifikimit dhe organizimit të sistemeve të paralajmërimit dhe informimit të publikut;
- hartimit dhe zbatimit të planeve operative për implementimin e masave mbrojtëse në terren.

2.6. Paralajmërimi publik

- Qeveria lokale siguron informimin dhe paralajmërimin në kohë, të qytetarëve, për rreziqet dhe situatat emergjente përmes:
- përgatitjes së mesazheve të qarta, të sakta dhe të bazuara në vlerësimin e rrezikut;
- përzgjedhjes dhe përdorimit të kanaleve të përshtatshme të komunikimit (sms, radio, televizione, rrjete sociale, sirena dhe medie lokale, rajonale dhe qendrore);
- shpërndarjes së informacionit për popullatën në zonat e prekura, duke përfshirë udhëzime të qarta për masat që duhet të ndërmerren;
- përditësimit të vazhdueshëm të informacionit në përputhje me zhvillimin e situatës.

2.7. Zbatimi i masave mbrojtëse

Masat mbrojtëse zbatohen në mënyrë të koordinuar nga institucionet përgjegjëse dhe përfshijnë:

- monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të progresit të zbatimit të masave mbrojtëse;
- kontrollin e qasjes dhe izolimin e zonave të rrezikshme për të parandaluar rrezikimin e mëtejshëm të popullatës;
- mbështetjen e procesit të evakuimit dhe, sipas nevojës, zbatimin e masave të dekontaminimit;
- ofrimin e ndihmës dhe trajtimit mjekësor për personat e lënduar dhe të prekur;
- sigurimin e mbështetjes për grupet e cënueshme, përfshirë personat me nevoja të veçanta;
- realizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në zonat e prekura.

Plani Operativ Emergjent Lokal

2.8. Nevojat afatgjata

Pas përfundimit të fazës emergjente, ndërmerren proceset afatgjata të rikthimit dhe rimëkëmbjes, me qëllim normalizimin e jetës në komunitet dhe forcimin e qëndrueshmërisë ndaj rreziqeve të ardhshme.

Rikthimi

Rivendosja e funksionimit normal të komunitetit, rikthimi i shërbimeve bazë dhe sigurimi i kushteve minimale për jetesë.

Rimëkëmbja

Riparimi dhe rindërtimi i infrastrukturës së dëmtuar, mbështetja e aktiviteteve ekonomike, si dhe përmirësimi gradual i kushteve të jetesës dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.

Organizimi dhe caktimi i përgjegjësive

Menaxhimi emergjent në Komunën e Rahovecit organizohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, parimet e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME) dhe Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI). Ky organizim siguron koordinim efektiv ndërinstitucional, përdorim efikas të burimeve dhe reagim të integruar gjatë situatave emergjente dhe fatkeqësive të ndryshme.

1. DREJTIMI

Kryetari i Komunës - zyrtarët e zgjedhur, janë autoriteti më i lartë për menaxhimin emergjent në nivel lokal dhe përgjegjës për:

- Shpalljen e gjendjes emergjente në përputhje me kompetencat ligjore;
- Aktivizimin e strukturave komunale emergjente;
- Kërkimin e mbështetjes nga niveli rajonal dhe qendror;
- Marrjen e vendimeve strategjike gjatë situatave emergjente;
- Miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL);
- Sigurimin e vazhdimësisë së operacioneve.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH):

DMSH-ja është struktura kryesore operacionale për menaxhimin emergjent në komunë dhe përgjegjëse për:

- Koordinimin e reagimit ndërinstitucional;
- Zbatimin e Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI);
- Koordinimin e Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME);
- Monitorimin e situatës emergjente dhe analizimin e rreziqeve;
- Sigurimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve relevante.

DMSH-ja ose koordinatori/zyrtari i Menaxhimit Emergjent (K\ZME): Koordinator/zyrtari i Menaxhimit Emergjent vepron si menaxher i Qendrës Operative Emergjente (QOE) dhe është përgjegjës për:

- Sigurimin e aktivizimit dhe të menaxhimit të QOE-së;
- Koordinimin operacional gjatë emergjencave;
- Mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit operacional;
- Mobilizimin dhe koordinimin e burimeve komunale;
- Bashkëpunimin me institucionet rajonale, qendrore dhe partnerët relevantë;
- Sigurimin e gatishmërisë operative dhe vazhdimësisë së funksioneve emergjente.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Struktura e operimit gjatë emergjencës

Post-Komanda e Incidentit (PKI):

PKI-ja organizohet në vendin e incidentit dhe është përgjegjëse për:

- Drejtimin dhe koordinimin e operacioneve taktike në terren;
- Menaxhimin e personelit dhe të burimeve operative;
- Vlerësimin e situatës dhe raportimin në QOE;
- Zbatimin e masave të sigurisë dhe mbrojtjes.

Qendra Operative Emergjente (QOE):

QOE-ja është struktura komunale për koordinimin strategjik dhe operacional gjatë emergjencave dhe përgjegjëse për:

- Monitorimin dhe analizimin e situatës emergjente;
- Koordinimin ndërinstitutional dhe ndërsektorial;
- Menaxhimin e informacionit dhe raportimit operacional;
- Koordinimin e logjistikës dhe burimeve emergjente;
- Mbështetjen e operacioneve në terren dhe të procesit të rimëkëmbjes.

QOE-ja aktivizohet pjesërisht ose plotësisht, në varësi të nivelit dhe ndikimit të emergjencës dhe funksionon në përputhje me procedurat standarde operative dhe parimet e Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI).

Drejtoritë komunale

Drejtoritë komunale, në kuadër të përgjegjësisë së tyre funksionale, kanë detyrime të qarta në fazat e përgatitjes reagimit dhe rimëkëmbjes nga emergjencat. Ato:

- Hartojnë, përditësojnë dhe mirëmbajnë planet sektoriale dhe Procedurat Standarde Operative (PSO) në përputhje me Planin Operativ Emergjent Lokal;
- Identifikojnë dhe planifikojnë burimet e nevojshme, përfshirë furnizimet, pajisjet, mjetet dhe kapacitete transportuese për reagim emergjent;
- krijojnë dhe mirëmbajnë marrëveshje për ndihmë reciproke me institucione dhe subjekte relevante, sipas nevojave operationale;
- Sigurojnë dokumentimin e plotë dhe të saktë të shpenzimeve dhe të veprimeve të ndërmarra gjatë fatkeqësive, në përputhje me kërkesat ligjore dhe financiare;
- Mbrojnë dhe ruajnë dokumentacionin dhe regjistrat esenciale për garantimin e vazhdimësisë së funksioneve qeverisëse;
- Përcaktojnë dhe mirëmbajnë listën e zëvendësimit dhe të radhës së komandës për personelin kyç në menaxhimin emergjent, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së vendimmarrjes.

Drejtoritë komunale obligohen të bashkërendojnë aktivitetet e tyre me Qendrën Operative Emergjente (QOE) gjatë të gjitha fazave të menaxhimit emergjent.

Funksionet Mbështetëse Emergjente (FME)

Institucionet publike dhe drejtoritë komunale, të organizuara në kuadër të **Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME)**, ofrojnë mbështetje, resurse dhe shërbime gjatë situatave emergjente. Këto funksione sigurojnë koordinim dhe aktiviteteve ndërinstitutionale dhe përdorimin efikas të burimeve për reagim dhe rimëkëmbje.

FME-të aktivizohen sipas nevojës dhe koordinohen përmes Qendrës Operative Emergjente (QOE) dhe Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI)

FME-të:

- Hartojnë, përditësojnë dhe mirëmbajnë planet funksionale dhe **Procedurat Standarde Operative (PSO)** për mbështetjen e operacioneve emergjente;

Plani Operativ Emergjent Lokal

- Identifikojnë dhe planifikojnë burimet e nevojshme për reagim emergjent, përfshirë furnizimet, pajisjet, mjetet transportuese dhe kapacitetet logjistike;
- Sigurojnë dokumentimin dhe mbajtjen e evidencave të sakta për shpenzimet dhe aktivitetet e ndërmarra gjatë fatkeqësive;
- Garantojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e dokumentacionit dhe të dhënave të rëndësishme për vazhdimësinë e funksioneve qeverisëse;
- Përcaktojnë dhe mirëmbajnë radhën e autorizimeve dhe zëvendësimit për personelin kyç emergjent, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së komandimit dhe vendimmartjes.

Sektori privat

Sektori privat luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e emergjencave, duke kontribuar me kapacitete, resurse dhe shërbime të ndryshme që mund të mbështesin reagimin institucional.

Në kuadër të Planit Operativ Emergjent Lokal, sektori privat mund të përfshihet në disa role, si:

- Pronarë ose operatorë të **infrastrukturës kritike**;
- Ofrues të shërbimeve emergjente private (si transportin, makinerinë e rëndë, shërbime ambulatorie private, kompani të pastrimit ambiental dhe shërbime teknike);
- Subjekte të obliguara ligjërish për të përgatitur dhe zbatuar masa parandaluese dhe mbrojtëse për objektet dhe aktivitetet e tyre;
- Pjesë e strukturave lokale të reagimit emergjent, përmes bashkëpunimit me institucionet publike.

Bashkëpunimi me sektorin privat realizohet përmes marrëveshjeve, koordinimit operacional dhe angazhimit të kapaciteteve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sektori privat ka përgjegjësinë të:

- Planifikojë dhe zhvillojë kapacitetet e veta për **gatishmëri, parandalim, reagim dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë**;
- Të jetë i informuar për procedurat dhe planet lokale të reagimit emergjent;
- Bashkëpunojë me institucionet komunale dhe të zbatojë masat mbrojtëse sipas nevojës ose udhëzimeve të **Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH)**;
- Siguron vazhdimësinë e shërbimeve kritike dhe mbështet rikthimin e funksioneve ekonomike pas fatkeqësive.

Menaxheri i Qendrës Operative Emergjente (QOE) - DMSH ose koordinatori/zyrtari i Menaxhimit Emergjent (K\ZME):

Vepron si **menaxher i Qendrës Operative Emergjente (QOE)**. Është përgjegjës për koordinimin e operacioneve emergjente në nivel komunal dhe menaxhimin e funksioneve operative të QOE-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të menaxherit të QOE-së janë:

- Përgatit dhe mirëmban objektin e **Qendrës Operative Emergjente (QOE)** të komunës, duke siguruar funksionalitetin e saj dhe qasjen në informacion për zyrtarët e autorizuar;
- Mban koordinim të vazhdueshëm me strukturat rajonale dhe institucionet përkatëse, duke siguruar shkëmbim të shpejtë dhe të saktë të informacionit mbi situatat emergjente;
- Identifikon rreziqet dhe dobësitë që mund të ndikojnë në territorin e komunës, në bashkëpunim me institucionet rajonale dhe qendrore;
- Identifikon dhe mobilizon burimet në dispozicion brenda komunës për reagim emergjent, si dhe koordinon kërkesat për ndihmë reciproke me partnerët institucionalë dhe strukturat rajonale;
- Zhvillon dhe mirëmban staf të trajnuar për reagim emergjent, si dhe harton lista kontrolli dhe procedura operative të përshtatshme për situata emergjente;

Plani Operativ Emergjent Lokal

- Aktivizon Qendrën Operative Emergjente dhe delegon funksionet operative gjatë emergjencave, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Planin Operativ Emergjent Lokal.
- Mbledh, regjistron dhe ruan aktivitetet e operacioneve emergjente;
- Merr pjesë në trajnime, ushtrime dhe punëtori të organizuara nga niveli rajonal, qendror ose nga organizata të tjera relevante, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve dhe procedurave të reagimit emergjent.

Menaxheri i QOE siguron funksionimin e integruar të Sistemit të Komandës së Incidentit (SKI) dhe koordinimin ndër-institucional gjatë gjithë fazave të menaxhimit emergjent.

a. Zyrtari për Informim Publik (ZIP) (dhe çështje të jashtme - FME # 15)

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionin e informimit publik;
 - b. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
 - c. Informon nga QOE-ja ose në vendngjarje sipas nevojës, lidhur me situatën emergjente;
 - d. Koordinon të gjitha informacionet e lëshuara në publik apo në medie me ZIP të regjionit dhe Qendrën e Përbashkët të Informimit;
 - e. Koordinon ndërgjegjësimin e publikut për informacion të medieve para një incidenti dhe siguron informata të sakta dhe në kohë për reagim dhe rimëkëmbje të operacioneve;
 - f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur të informimit publik, DMSH ose K\ZME rreth aktiviteteve;
 - g. Zhvillon dhe harton njoftimet e parapërgatitura (të shkruara) për përdorim gjatë situatave të jashtëzakonshme;
 - h. Zhvillon dhe shpërndan informacionin publik/materialet arsimore lidhur me masat që do të merren gjatë një emergjence, duke përfshirë informacionet në lidhje me vendstrehimin, rrugët e evakuimit, vendet e strehimit, transportit, pikat e grumbullimit etj.;
 - i. Punon si pjesë e Qendrës për Informim të Përbashkët (QPIP), të përcaktuar nga zyrtarët e regjionit apo të shtetit.
- b. Zyrtari për siguri - Monitoron kushtet e sigurisë dhe zhvillon masat për të siguruar sigurinë e të gjithë personelit të caktuar.
- c. Zyrtari ndërlidhës - shërben si kontakt i parë në mbështetjen e agjencive për të ndihmuar në incident.

2. Sektori i Operativës (koordinatori\zyrtari i Menaxhimit të Emergjencave) ose një i deleguar):

Është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësi të të gjitha degëve të caktuara. Shefi i sektorit duhet të mbajë përgjegjësi për drejtorët e degëve ose të deleguarit e tyre, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit. Shefi i sektorit koordinon punën në bazë të detyrave të caktuara nga drejtori i degës dhe raporton te menaxheri i QOE-së për përparimin dhe statusin e misioneve të caktuara.

Sektori i Operativës përbën komponentin kryesor të koordinimit operacional gjatë reagimit emergjent

Plani Operativ Emergjent Lokal

DETYRAT E DREJTORIVE, SEKTORËVE DHE ZYRAVE

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKKI)

Komunikimi (FME # 2):

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionimin e komunikimit;
- b. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- c. Trajnon anëtarët e stafit në funksionimin e sistemit të komunikimit;
- d. Siguron mundësinë për të komunikuar ndërmjet QOE-së, operacioneve në terren dhe regjionit;
- e. Ndhmon në njoftimin e qytetarëve të komunës;
- f. Reagon në QOE ose në vendin e incidentit (teren), sipas nevojës;
- g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur të komunikimit dhe **K/ZME** rreth aktiviteteve, dhe
- h. Kryen përgjegjësitë e tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

DREJTORIA KOMUNALE PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Zjarrfikja (FME # 4):

- a. Zhvillon dhe mirëmban listat kontrolluese për funksionin e zjarrfikësve;
- b. Mbështet zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- c. Raporton në QOE ose në vendin e incidentit sipas nevojës;
- d. Koordinon të gjitha shërbimet e zjarrfikjes dhe të shpëtimit;
- e. Siguron mënyrën e njoftimit të publikut dhe informimin emergjent;
- f. Ndhmon në evakuimin e qytetarëve të prekur, duke përfshirë personat e bllokuar, të plagosur ose të institucionalizuar;
- g. Siguron furnizim emergjent me energji elektrike dhe ndriçim për operacionet emergjente;
- h. Mbështet operacionet e riaftësimit dhe pastrimin e rrënojave;
- i. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe koordinatorin/zyrtarin e Menaxhimit Emergjent (KME) mbi aktivitetet e zjarrfikjes dhe shpëtimit;
- j. Kryen detyrat e tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

Kërkimi dhe Shpëtimi (FME # 9):

- a. Merr pjesë në zhvillimin, rishikimin dhe mirëmbajtjen e procedurave operative që lidhen me funksionimin e Qendrës Operative Emergjente (QOE) ;
- b. Raporton në Qendrën Operative Emergjente (QOE) ose në vendin e incidentit, sipas nevojës dhe sipas kërkesës së strukturës komanduese;
- c. Koordinon aktivitetet dhe shërbimet e kërkimit dhe shpëtimit në territorin e komunës gjatë situatave emergjente;
- d. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe **koordinatorin/zyrtarin e Menaxhimit të Emergjencave (K/ZME)** lidhur me operacionet dhe kapacitetet e kërkimit dhe shpëtimit;
- e. Kryen detyra dhe përgjegjësi të tjera sipas kërkesës së **shefit të Sektorit të Operativës** ose menaxherit të QOE-së.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Shëndetësia/mjekësia (FME # 8):

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për funksionin e shërbimeve shëndetësore/mjekësore;
- b. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- c. Raporton në QOE ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;

Plani Operativ Emergjent Lokal

- d. Mirëmban një listë të banorëve me nevoja të veçanta, siguron kopje për komunën dhe regjionin;
- e. Koordinon aktivitetet e urgjencës mjekësore brenda komunës;
- f. Koordinon nevojat institucionale për transport nëse bëhet e domosdoshme zhvendosja ose evakuimi nëpër spitale, shtëpi të shëndetit, kujdesit ditor, shtëpi të kujdesit personal apo kujdestarëve të objekteve;
- g. Koordinon shërbimet mjekësore të nevojshme për të mbështetur operacionet e strehimit;
- h. Ndhmon në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit;
- i. Ndhmon në shërbimet mortore;
- j. Ndhmon në dispozitat e inokulimit për parandalimin e sëmundjeve;
- k. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe K\ZME rreth veprimtarive të shëndetit publik / shërbimeve mjekësore;
- l. Koordinon imunizimin e punëtorëve emergjentë;
- m. U referohet nevojave të transportit (kujdesi shëndetësor, nevojave speciale) për zyrtarët e logjistikës;
- n. Koordinon dhe bashkëpunon me njësitë e përshtatshme dhe agjencitë lidhur me çështjet e shëndetit publik, duke përfshirë edhe raportimin e sëmundjeve ngjitëse dhe krijimin e zonave karantinë, dhe
- nj. Kryen përgjegjësitë e tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

INSPEKTORËT E PARANDALIMIT NGA ZJARRI DHE FATKEQESITË E TJERA

Reagimi për naftë dhe materiale të rrezikshme (FME # 10):

- a. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- b. Raporton brenda QOE-së ose në vendin e incidentit sipas nevojës;
- c. Koordinon me ekipin për Materiale të Rrezikshme, siç është e përshtatshme;
- d. Koordinon dezinfektimin dhe monitorimin e qytetarëve të prekur dhe punëtorëve emergjentë pas ekspozimit nga rreziqet kimike ose radiologjike;
- e. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe KME-në rreth aktiviteteve për materiale të rrezikshme;
- f. Kryen përgjegjësitë e tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

POLICIA E KOSOVES

Siguria publike (FME # 13):

- a. Zhvillon dhe mban një listë kontrolluese për siguri publike dhe funksionimit të sigurisë;
- b. Ndhmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- c. Raporton brenda QOE-së ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- d. Koordinon shërbimet e sigurisë dhe zbatimit të ligjit;
- e. Krijon siguri dhe mbrojtje të objekteve të rëndësishme, duke përfshirë QOE-në;
- f. Siguron qasje dhe kontroll të trafikut përreth dhe në zonat e prekura;
- g. Ndhmon përmes linjave të alarmimit dhe njoftimit për popullatën e kërcënuar.
- h. Ndhmon në evakuimin e qytetarëve të prekur, veçanërisht atyre që janë të institucionalizuar, ngujuar ose të plagosur;
- i. Ndhmon në instalimin e shenjave emergjente të jashtëzakonshme dhe pajisjeve të tjera të lëvizjes së trafikut;
- j. Ndhmon në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit;
- k. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe K\ZME për siguri publike dhe operacionet e sigurisë;
- l. Themelon dhe siguron shërbimet e sigurisë të lokacioneve për strehim që operojnë në vende të

Plani Operativ Emergjent Lokal

komunës;

- m. Ndihmon operatorët për strehim në shfaqjen e klientëve me histori kriminale duke përfshirë kundërvajtësit seksualë.
- n. Themelon patrullat e sigurisë për ndonjë zonë të evakuuar, nëse lejojnë kushtet;
- o. Bashkëpunon me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në lidhje me hetimet, sigurinë e vendit të ngjarjes etj., dhe
- p. Kryen përgjegjësitë e tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

3. Sektori i Planifikimit (Koordinatori\Zyrtari i Menaxhimit Emergjent ose ndonjë i deleguar):

Është përgjegjës për të siguruar funksionimin e menaxhimit emergjent sipas përgjegjësive. Shefi i seksionit duhet të mbajë përgjegjësi për drejtimin e degës ose të delegojë detyra, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit. Shefi i seksionit koordinon punën dhe detyrat e caktuara nga drejtori i degës dhe i raporton menaxherit të QOE-së në përparimin dhe statusin e misionëve të caktuara.

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim Menaxhimi emergjent (FME#5):

- a. Mbledh, analizon dhe vlerëson informacionet që lidhen me incidentin dhe zhvillimin e situatës emergjente;
- b. Përcakton statusin e burimeve dhe monitoron përdorimin dhe dislokimin e tyre gjatë operacioneve emergjente;
- c. Përgatit dhe dokumenton **planet e veprimit të incidentit (PVI)** në bashkëpunim me strukturat operative të QOE-së;
- d. Kërkon dhe përpunon raporte informative, të dhëna operative dhe paraqitje grafike ose skema që ndihmojnë në analizën e situatës;
- e. Mbikëqyr përgatitjen dhe përditësimin e **Planit të Menaxhimit të Incidentit** gjatë zhvillimit të operacioneve emergjente;
- f. Mbledh dhe analizon informacionet mbi strategjitë alternative të reagimit dhe masat e mundshme për menaxhimin e incidentit;
- g. Kryen detyra dhe përgjegjësi të tjera sipas udhëzimeve të **shefit të Sektorit të Operativës** ose menaxherit të QOE-së.

4. Sektori i Logjistikës (koordinatori\zyrtari i Menaxhimit Emergjent ose një i deleguar):

Është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësive të të gjitha detyrave/degët e caktuara. Shefi i seksionit duhet të mbajë përgjegjësitë e drejtorit të degës, ose të delegojë ato, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit. Shefi i seksionit koordinon punën me detyrat e caktuara nga drejtori i degës dhe i raporton menaxherit të QOE-së për përparimin dhe statusin e detyrave të caktuara. Sektori i Logjistikës gjithashtu siguron mbështetje logjistike për QOE-në.

Plani Operativ Emergjent Lokal

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE SEKTORI PRIVAT

Transporti (FME # 1):

- a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- b. Reagon brenda QOE-së ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- c. Mirëmban një listë të burimeve të transportit dhe informacionet kontaktuese duke përfshirë kapacitetet në komuna;
- d. Koordinon burimet e furnizimit gjatë transportit emergjent;
- e. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe K\ZME-në rreth aktiviteteve të transportit, dhe
- f. Kryen përgjegjësi të tjera të caktuara nga shefi i sektorit.

Punët publike dhe të inxhinierisë (FME#3):

- a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- b. Raporton brenda QOE-së ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- c. Mirëmban një listë të aseteve dhe të punëve publike;
- d. Shërben si ndërlidhje në mes të punëve publike të komunës dhe QOE-së;
- e. Koordinon caktimin e burimeve të punëve publike;
- f. Siguron informacion mbi ujin, kanalizimin, ndërtimin dhe riparimin e rrugëve, inxhinierinë, inspektimin e ndërtimit dhe mirëmbajtjes;
- g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe K\ZME-në dhe rreth punëve publike dhe veprimtarive inxhinierike, dhe
- h. Kryen përgjegjësi të tjera të caktuara nga shefi i sektorit.

KRYQI I KUQ I KOSOVËS – Dega në Rahovec

Kujdesi masiv, strehimi dhe shërbimet humane (FME#6):

- a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- b. Raporton brenda QOE-së ose në vendin e incidentit, sipas nevojës;
- c. Ndihmon administratorin emergjent të Komunës (FME # 6) në mbajtjen e një liste të kujdesit masiv - objektet për strehim, duke përfshirë kapacitetet;
- d. Koordinon me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe agjencitë e tjera të përshtatshme;
- e. Përgjigjet në kërkesat për kujdes masiv – strehim, në mbështetjen për rajonin gjatë emergjencave;
- f. Koordinon me FME#1 (transporti) dhe FME#7 (menaxhimi i burimeve) në lidhje me çështjet e evakuimit;
- g. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe K\ZME rreth kujdesit masiv, zhvendosjen dhe veprimtaritë e strehimit, dhe
- h. Kryen përgjegjësitë e tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT

Dega e mbështetjes me burime (FME#7):

- a. Koordinon për materialet, shërbimet dhe objektet në mbështetjen emergjente;
- b. Zhvillon procedurat për urdhra të shpejta për furnizime dhe pajisje dhe përcjell shpërndarjen dhe përdorimin e tyre;
- c. Merr pjesë në përgatitjen e planit të menaxhimit të incidenteve;
- d. Lehtëson marrjen e furnizimeve emergjente për punëtorët, duke përfshirë ushqimin, ujin dhe

Plani Operativ Emergjent Lokal

nevojat themelore;

- e. Lehtëson blerjen e furnizimeve, siç kërkohet, me ushqim, ujë dhe nevojat për operatorët e strehimit;
- f. Siguron, ndjek dhe koordinon burimet e transportit (autobusë, furgonë, ambulanca shtesë, kamionë etj.);
- g. Ngre pikat fushore për burimet e furnizimit dhe të transportit;
- h. Merr furnizime dhe koordinon shpërndarjen e karburantit emergjent për furnizimin e automjeteve emergjente, objekteve kritike të përshtatshme për evakuim, si dhe
- i. Kryen përgjegjësi të tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

DREJTORIA PËR BUJQËSI

Dega e Burimeve Bujqësore dhe Natyrore (FME#11):

- a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- b. Raporton brenda QOE-së ose në vendin e incidentit (VI), sipas nevojës;
- c. Mban një listë për ushqimin dhe kujdesin e kafshëve dhe kontrollin e pasurive;
- d. Shërben si ndërlidhje në mes të QOE-së dhe çështjeve të ushqimit për komunitetet;
- e. Koordinon shpërndarjen e informacionit për ushqimin dhe kujdesin e kafshëve dhe kontrollin në komunitet;
- f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe K\ZME lidhur me kujdesin bujqësor, të kafshëve dhe çështjet e kontrollit;
- g. Koordinon aktivitetet lokale për strehim të kafshëve me zyrtarët e regjionit me FME#11 dhe ekipin ndërlidhës reagues për kafshë, dhe
- h. Kryen përgjegjësitë e tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

KORPORATA ELEKTRO-ENERGJETIKE – KEDS Rahovec

Dega e energjisë (FME#12):

- a. Ndihmon në zhvillimin, shqyrtimin dhe mirëmbajtjen e QOE-së;
- b. Raporton në QOE ose në vendin e incidentit VI, sipas nevojës;
- c. Mban një listë për energji dhe shërbime të pasurive;
- d. Shërben si ndërlidhje ndërmjet QOE-së dhe shërbimeve komunale të energjisë;
- e. Koordinon shpërndarjen e informacionit ndërmjet degës së energjisë/shërbimeve komunale;
- f. Këshillon zyrtarët e zgjedhur dhe K/ZME lidhur me çështjet e energjisë, dhe
- g. Kryen përgjegjësitë e tjera të caktuara nga shefi i seksionit.

Sektori i Financave dhe i Administratës (K/ZME, zyrtarët e zgjedhur dhe/ose si të deleguar):

Është përgjegjës për të siguruar përmbushjen e përgjegjësiave të rimëkëmbjes afatgjate dhe zbutjes. Shefi i Seksionit duhet të mbajë përgjegjësinë e drejtorit të degës, ose t'ua delegojë atyre, varësisht nga situata dhe disponueshmëria e personelit. Shefi i Seksionit koordinon punën e degës sipas detyrave të caktuara nga drejtori dhe përcjell raportet te menaxheri i QOE-së për përparimin dhe statusin e misionëve të caktuara. Sektori gjithashtu mban regjistrimet e financave dhe të personelit për aktivitetet reaguese emergjente.

Plani Operativ Emergjent Lokal

DREJTORIA PËR FINANCA

Rimëkëmbja e komunitetit dhe zbutja (FME #14):

- Mbikëqyr dhe mban nën kontroll të gjitha analizat e kostos financiare dhe aktivitetet që lidhen me emergjencën;
- Përcakton kostot dhe të dhënat kohore të personelit;
- Koordinon zhvillimin e vlerësimit të dëmeve;
- Fillon planifikimin për rimëkëmbjen e funksioneve jetike të komunitetit, dhe
- Kryen përgjegjësitë e tjera të caktuara nga shefi seksionit.

A. Zyrtarët e zgjedhur (kryetari dhe drejtorët e drejtorive), janë përgjegjës për mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve. Ata ushtrojnë mbikëqyrjen kryesore dhe kontrollin mbi të katër fazat e menaxhimit emergjent: parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen në kuadër aktiviteteve emergjente në komunës.

B. Koordinator\zyrtari i menaxhimit emergjent (K\ZME-DMSH ose ndonjë drejtor tjetër i emëruar), do të veprojë në emër të zyrtarëve të zgjedhur. Qendra Operative Emergjente (QOE) është caktuar nga komuna dhe mund të aktivizohet nga koordinatori\zyrtari i menaxhimit emergjent (K\ZME), apo nga zyrtarët e zgjedhur gjatë një emergjence. Një zëvendës i K\ZME-së dhe një QOE alternative do të caktohen për të funksionuar në rastin kur K\ZME primar dhe QOE nuk janë në dispozicion.

C. Ky plan përfshin parimet për “të gjitha rreziqet”, sepse shumica e funksioneve të reagimit emergjent janë të njëjta, pavarësisht nga rreziku. K\ZME do të bëjë mobilizimin e burimeve të personelit që kërkohet sipas situatës emergjente.

D. Koordinator\zyrtari i menaxhimit të emergjencave (K\ZME-DMSH) dhe zyrtarët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për ndihmë reciproke me komunat fqinje për ndihmë emergjente, nëse është e nevojshme.

E. Komuna do të shfrytëzojë Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME-2010) dhe Sistemin e Komandimit të Incidenteve (shih më poshtë).


Koncepti i operacioneve

Renditja e veprimeve

Ky seksion përshkruan menaxhimin e incidentit dhe veprimet që shkojnë nga kërcënim, njoftimi fillestar, deri në fillimin e koordinimit të përpjekjeve për të vlerësuar dhe ndërprerë kërcënimin, përgatitjen për aktivizimin e strukturës së FME-së, vendosjen e burimeve për reagim dhe operacione në incident, në mbështetje të rimëkëmbjes. Këto veprime nuk ndodhin domosdoshmërisht në mënyrë të njëpasnjëshme, shumë prej tyre janë në bashkëveprim, prandaj duhet të ndërmerren reagime individuale ose të shumëfishta ndaj këtyre incidenteve.

Plani Operativ Emergjent Lokal


ORGANIZIMI



Kur Qendra Operative Emergjente (QOE) lokale është e aktivizuar, duhet të ketë koordinim midis menaxherit/zyrtarit të menaxhimit emergjent dhe komandantit të incidentit për të siguruar një reagim të qëndrueshëm:


- QOE-ja ndjek strukturën e SKI-së (Sistemi i Komandimit të Incidentit), si dhe FME-të duhet të lidhen me stafin e SKI-në.
- 1. **Komandanti i Incidentit (KI)** do të trajnohet për vendin e incidentit në bazë të kërkesave të SIME-së (Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave). Në mënyrë të njëjtë, stafi i QOE-së, gjithashtu, do të jetë i trajnuar sipas kërkesave të SIME-së.
- 2. **Post-Komandën e Incidentit, në vendngjarje duke përdorur SKI:**
Zinxhir të qartë komandues, ku autoriteti dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në mënyrë të qartë.
- 3. **Sistemi i Komandimit të Incidenteve (SKI)** duhet të ketë:
 - Një strukturë mbikëqyrëse/kontrolluese (staf prej 3 – 7 (optimale 5);
 - Përgjegjësia e personelit (çdo person i raporton vetëm një personi në zinxhirin e komandës), dhe
 - Postet funksionale do të plotësohen vetëm kur paraqitet nevoja reale. Përgjegjësitë e posteve të paplotësuara do të mbulohen përkohësisht nga stafi ekzistues, ndërsa në të ardhmen këto funksione pritet të riorganizohen dhe të mbulohen përmes krijimit të pozitave më të avancuara.

Post-Komanda e Incidentit (PKI)




Plani Operativ Emergjent Lokal

Skema në vijim është një shembull i stafit të një QOE. Më shumë detaje duhet të ofrohen në anekset FME.




Sektori i Operacioneve



Plani Operativ Emergjent Lokal


FME-të e Shërbimeve Emergjente



FME-të e Shërbimeve humane


FME-të e Mbështetjes së infrastrukturës

Shënim: Të gjitha juridiksionet kanë personel FME të mbështetjes së infrastrukturës dhe mund të modifikohen sipas nevojës.




Plani Operativ Emergjent Lokal

FME-të e Sektorit të Planifikimit



FME-të e Sektorit të Logjistikës



SEKUENCA E VEPRIMEVE

Veprimet e menaxhimit të incidentit zhvillohen në mënyrë dinamike dhe jo domosdoshmërisht lineare. Ato përfshijnë:

1. Njoftimin fillestar të kërcënimit;
2. Vlerësimin fillestar të situatës;
3. Aktivizimin e pjesshëm ose të plotë të QOE-së;
4. Dislokimin e resurseve;
5. Reagimin emergjent;
6. Rimëkëmbjen;
7. Zbatimin e masave të zbutjes.

Shumë nga këto veprime mund të zhvillohen në mënyrë paralele dhe të ndërvarur, me qëllim sigurimin e një reagimi të shpejtë dhe efektiv ndaj incidentit.

Operacionet e zakonshme/ joemergjente

Këto janë veprime që ndërmerren gjatë periudhave joemergjente, me qëllim përgatitjen e kapaciteteve lokale për reagim efektiv në rast emergjence. Në këtë fazë, komuna zbaton këto aktivitete:

1. Informimin dhe edukimin e publikut përmes medieve lokale, broshurave, publikimeve zyrtare, numratoreve telefonike, web-faqes së komunës dhe kanaleve të tjera të komunikimit;
2. Hartimin, rishikimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e POEL dhe procedurave standarde operative;
3. Organizimin e trajnimeve dhe ushtrimeve periodike për testimin e planeve dhe rritjen e gatishmërisë;
4. Përditësimin dhe verifikimin e listave të kontakteve emergjente, resurseve dhe kontraktuesve.
5. Testimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të alarmimit dhe komunikimit;
6. Planifikimin e vazhdimësisë së qeverisjes dhe funksioneve esenciale;
7. Sigurimin që POEL përfshin mekanizma për njoftimin e institucioneve përkatëse, përfshirë autoritetet kompetente për menaxhimin e rasteve me viktime, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Këto aktivitete synojnë të rrisin gatishmërinë institucionale dhe të reduktojnë kohën e reagimit gjatë emergjencave.

VEPRIMET PARA INCIDENTEVE - ALARMIMI DHE PARALAJMËRIMI

Këto janë veprime që zbatohen në rast se menaxheri/zyrtari i Menaxhimit Emergjent merr njoftimin për një ngjarje të jashtëzakonshme nga Qendra e Situatave ose paralajmërime të tjera nga burime të besueshme.

Këto veprime përfshijnë:

- Komunikimin e njoftimeve dhe paralajmërimeve për publikun dhe institucionet përkatëse;
- Sigurimin e shëndetit dhe të sigurisë publike;
- Sigurimin e shëndetit dhe të mbrojtjes së reaguesve;
- Marrjen e masave për mbrojtjen e pronës;
- Aktivizimin e pjesshëm të Qendrës Operative Emergjente (QOE), sipas natyrës së emergjencës;
- Raportimin e situatës tek organet e qeverisë lokale.

Veprime specifike:

1. Alarmimi dhe mobilizimi i personelit të menaxhimit emergjent, si dhe caktimi i strukturës së angazhimit të personelit.
2. Përcaktimi dhe zbatimi i masave paraprake mbrojtëse në funksion të përgatitjes për një situatë të mundshme emergjente.

VEPRIMET REAGUESE

Veprimet reaguese ndërmerren menjëherë pas ndodhjes së emergjencës dhe synojnë menaxhimin efektiv të situatës dhe minimizimin e pasojave.

Objektivat kryesore janë:

- Ruajtja e jetës dhe e shëndetit të popullsisë;
- Mbrojtja e pronës dhe e mjedisit;
- Stabilizimi i situatës emergjente.

Këto veprime përfshijnë:

- Zbatimin e ligjit dhe sigurimin e rendit publik;
- Operacionet e zjarrfikjes dhe të shpëtimit;
- Ofrimin e shërbimeve mjekësore emergjente;
- Evakuimin e popullsisë nga zonat e rrezikuara;
- Sigurimin e strehimit emergjent;
- Operacionet e kërkim-shpëtimit;
- Shpërndarjen e furnizimeve emergjente;
- Menaxhimin dhe pastrimin e rrënojave;
- Mbrojtjen e infrastrukturës kritike;

Gjatë kësaj faze, funksionet jothelbësore të administratës komunale mund të pezullohen përkohësisht për të përqendruar burimet në menaxhimin e emergjencës.

Disa çështje që duhet marrë në shqyrtim në momentet gjatë incidentit, janë këto:

1. Funksionet ditore të qeverisjes që nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në operacionet emergjente, mund të pezullohen përkohësisht gjatë fazës së reagimit;
2. Përpjekjet dhe burimet mund të ridrejtohen për përmbushjen e detyrave prioritare emergjente.

Plani Operativ Emergjent Lokal

3. Evakuimi i popullsisë urdhërohet dhe zbatohet sipas nevojës;
4. Strehimoret emergjente hapen dhe menaxhohen nga personeli përgjegjës.

Pas përfundimit të operacioneve të menjëhershme për shpëtimin e jetës, fokusi zhvendoset në operacionet e rimëkëmbjes dhe, kur është e zbatueshme, në masat për zbutjen (zvogëlimin) e rrezikut.

VEPRIMET E RIMËKËMBJES

Veprimet e rimëkëmbjes ndërmerren pas përfundimit të reagimit fillestar dhe synojnë kthimin e komunitetit në gjendje normale funksionimi sa më shpejt dhe në mënyrë të qëndrueshme.

Këto veprime përfshijnë:

- Vlerësimin paraprak të dëmeve;
- Zbatimin e masave afatshkurtra dhe afatgjata të rimëkëmbjes;
- Pastrimin dhe rindërtimin e objekteve publike, bizneseve dhe vendbanimeve;
- Rikthimin e banorëve dhe parandalimin e dëmeve të mëtejshme nga faktorët natyrorë;
- Mbrojtjen e vendeve kulturore dhe arkeologjike gjatë operacioneve të rimëkëmbjes.

Çështje të tjera gjatë rimëkëmbjes:

- Hapja e një zyre të përbashkët fushore (ZPF), nëse ngjarja shpallet fatkeqësi në nivel lokal ose shtetëror. Kjo zyrë shërben si pikë qendrore koordinimi ndërmjet institucioneve shtetërore, lokale dhe organizatave vullnetare.
- Brenda 72 orëve nga ngjarja:
 1. Kryhet vlerësimi fillestar i dëmeve dhe raportohet në Qendrën Operative Emergjente (QOE) (lokale ose qendrore);
 2. Vlerësohet infrastruktura kritike dhe përcaktohet mundësia për rikthimin e banorëve;
 3. Fillon menjëherë rikthimi i shërbimeve esenciale (energji elektrike, ujë i pijshëm, kanalizime etj.).

Veprimet e zbutjes (zvogëlimit të rrezikut)

Këto veprime synojnë zvogëlimin ose eliminimin e rreziqeve afatgjata ndaj njerëzve, pronës dhe mjedisit.

Gjatë këtij procesi adresohen:

- Përdorimi i granteve (financime të jashtme) për masa të zvogëlimit të humbjeve, kur ato janë të disponueshme;
- Shfrytëzimi i ekspertizës shkencore për ndërtim më të sigurt;
- Koordinimi me programe kombëtare dhe ndërkombëtare për menaxhimin e rreziqeve (p.sh. përmytjet);
- Hartëzimi i zonave të rrezikuara për planifikim më të mirë të rimëkëmbjes dhe zbutjes;
- Përdorimi i modeleve parashikuese për mbrojtjen e infrastrukturës kritike;
- Dokumentimi i humbjeve të shmangura falë masave parandaluese;
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut.

Veprime konkrete:

1. Rishikimi dhe përditësimi i planit për zvogëlimin e rreziqeve;
2. Zhvillimi i projekteve për përfitim të granteve për zbutje, në bashkëpunim me institucionet përkatëse;
3. Integrimi i masave zbutëse në rindërtimin e infrastrukturës së dëmtuar.

SHPLLJA E GJENDJES SË GATISHMËRISË

Gjendja e gatishmërisë shpallet në rastet kur ekziston një kërcënim serioz për jetën, pronën ose mjedisin dhe kur kërkohet një reagim i koordinuar institucional.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Ajo mund të shpallet nga:

- Kryetari i Komunës;
- Nënkryetari i Komunës (në mungesë të Kryetarit);
- Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim (në mungesë të Kryetarit dhe të Nënkryetarit, në përputhje me kompetencat ligjore);
- Një i deleguar nga Kryetari i Komunës.

Aktivizimi i Qendrës Operative Emergjente (QOE)

Menaxheri/zyrtari për menaxhim emergjent ose koordinatori, mund të aktivizojë QOE-në në këto raste:

- Kur ekziston kërcënim i menjëhershëm ndaj sigurisë ose shëndetit publik në shkallë të gjerë;
- Kur kërkohet koordinim ndërinsitucional i shumë agjencive për menaxhimin e emergjencës ose rimëkëmbjen;
- Kur emergjenca prek disa njësi administrative që varen nga të njëjtat burime;
- Kur, për kontrollin e ngjarjeve të mëdha emergjente apo fatkeqësive, zbatohen direktivat emergjente lokale.

Disponueshmëria e stafit dhe nevojat operacionale mund të kërkojnë kombinimin e roleve ose mosplotësimin e disa pozitave të caktuara, ku përgjegjësitë transferohen te nivele më të larta menaxheriale.

Komunikimi, alarmimi dhe paralajmërimi për publikun sigurohen përmes Sistemit të Alarmimit Emergjent (SAE), si dhe përmes kanaleve të tjera të disponueshme.

Komunikimi dhe alarmimi

Informimi i publikut realizohet përmes:

- Sistemit Emergjent të Alarmimit;
- Faqes zyrtare të Komunës;
- Medieve lokale;
- Rrjeteve sociale zyrtare;
- Komunikimeve direkte emergjente.

Evakuimi dhe strehimi

Në rast evakuimi:

- Popullsia udhëzohet të përdorë mjetet personale kur kjo është e mundur;
- Organizohen transporte për personat që nuk disponojnë mjete transporti;
- Përcaktohen zona të sigurta brenda ose jashtë territorit të komunës;
- Trafiku menaxhohet nga autoritetet përkatëse;
- Hapen strehimore emergjente sipas nevojës.

Personat që evakuohen duhet të ndjekin me kujdes udhëzimet dhe drejtimin e dhënë nga punonjësit e emergjencës, koordinorët e trafikut dhe zyrtarët përgjegjës për menaxhimin e situatës. Rrugët e evakuimit do të përcaktohen në bazë të rrethanave të momentit dhe do të përdoren vetëm kur konsiderohen të sigurta dhe të realizueshme. Në zonat kritike, do të angazhohet personel i posaçëm për kontrollin e trafikut, me qëllim që të sigurohet një lëvizje e organizuar, e qetë dhe e sigurt e njerëzve dhe automjeteve.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Përfundim

Ky koncept i operacioneve siguron një qasje të integruar, të koordinuar dhe të standardizuar për menaxhimin e emergjencave në komunën e Rahovecit, duke garantuar:

- Qartësi në komandim;
- Koordinim efektiv;
- Përdorim racional të burimeve;
- Mbrojtje maksimale të jetës dhe të pronës.

Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit

Grumbullimi, verifikimi dhe shpërndarja e informacionit gjatë operacioneve emergjente koordinohen nga **Qendra Operative Emergjente (QOE)** e Komunës së Rahovecit. Informacioni mblidhet në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet përgjegjëse, ekipet e reagimit në terren dhe përfaqësuesit e Funksioneve Mbështetëse Emergjente (FME), duke përfshirë të dhëna të përditësuara mbi situatën.

Informacioni i verifikuar analizohet nga QOE-ja dhe shpërndahet te strukturat vendimmarrëse komunale, institucionet përgjegjëse operacionale dhe, sipas nevojës, tek autoritetet kompetente në nivel qendror. Shkëmbimi i informacionit realizohet përmes kanaleve zyrtare të komunikimit (radiolidhjet, linjat telefonike të dedikuara, postë elektronike etj.) dhe mjeteve alternative në rast të ndërprerjes së sistemeve primare.

QOE përgatit raporte periodike të situatës, në intervale të rregullta kohore, për të mbështetur koordinimin taktik dhe vendimmarrjen strategjike. Informimi zyrtar i publikut realizohet nga zyrtari për informim publik në koordinim të plotë me QOE-në, me qëllim të sigurimit të informacionit të saktë, në kohë dhe të parandalimit të dezinformatave. Procedurat e detajuara të raportimit, formatet standarde dhe afatet kohore përcaktohen në Procedurat Standarde Operative (PSO).

Komunikimi

- Komunikimi gjatë situatave emergjente dhe fatkeqësive realizohet përmes Qendrës Operative Emergjente (QOE) dhe institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave. Të gjitha institucionet dhe subjektet e përfshira në reagim janë të obliguara të sigurojnë komunikim të vazhdueshëm, raportim të rregullt dhe shkëmbim të saktë të informacionit operacional;
- Shkëmbimi i informacionit realizohet përmes telefonisë fikse dhe mobile, radiolidhjeve operative, postës elektronike zyrtare, platformave elektronike dhe sistemeve të tjera të komunikimit në dispozicion.
- Në rast të ndërprerjes së sistemeve primare të komunikimit, aktivizohen mjetet alternative të komunikimit, si: radiolidhjet operative; radiot portative të ekipeve emergjente; posta elektronike rezervë dhe platformat alternative elektronike; dërgimi fizik i njoftimeve dhe korrierëve në rast të ndërprerjes së plotë të komunikimeve elektronike.

QOE koordinon pranimin, verifikimin dhe shpërndarjen e informacionit ndërmjet institucioneve komunale, policisë, zjarrfikësve, institucioneve shëndetësore, shërbimeve emergjente dhe subjekteve të tjera operative. Raportimet operative dhe njoftimet emergjente realizohen sipas procedurave standarde të komunikimit dhe afateve të përcaktuara.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Administrata, Financat dhe Logjistika

Ky seksion përcakton parimet, procedurat dhe përgjegjësitë për administrimin, menaxhimin financiar dhe mbështetjen logjistike gjatë situatave emergjente dhe fatkeqësive në komunën e Rahovecit.

Në këtë seksion adresohen:

- ☐ Marrëveshjet për ndihmë reciproke dhe koordinim ndërinstitucional;
- ☐ Procedurat për angazhimin e personelit shtesë, përfshirë riemërimin, aftësimin dhe përfshirjen e vullnetarëve;
- ☐ Politikat për menaxhimin financiar, administrimin e burimeve dhe dokumentimin e shpenzimeve emergjente;
- ☐ Procedurat për identifikimin, mobilizimin, shpërndarjen dhe monitorimin e përdorimit të burimeve gjatë emergjencave.

Të gjitha resurset e komunitetit (burimet njerëzore, objektet, pajisjet dhe kapacitetet logjistike) vihen në dispozicion të **Kryetarit të Komunës së Rahovecit** për menaxhimin dhe drejtimin e reagimit ndaj emergjencave.

Kryetari i Komunës mund të delegojë këtë autoritet te një i emëruar ose te koordinatori\zyrtari i menaxhimit emergjent, në përputhje me aktet përkatëse për delegimin e autoritetit.

Duhet të përcaktohen politika dhe procedura të qarta për:

- Evidentimin dhe raportimin e shpenzimeve emergjente;
- Menaxhimin financiar gjatë emergjencave;
- Kontrollin, monitorimin dhe transparencën e fondeve publike dhe donacioneve.

Në situata emergjente, procedurat standarde të prokurimit dhe administrimit financiar mbeten në fuqi. Megjithatë, në raste të jashtëzakonshme mund të zbatohen procedura të përsheptuara, në përputhje me dispozitat ligjore, për të siguruar reagim më efikas dhe të shpejtë.

a. Administrata

Në kuadër të Planit Operativ Emergjent Lokal të Komunës së Rahovecit, Qeveria Komonale siguron raportimin e rregullt të situatës, kërkesave për ndihmë dhe vlerësimeve të dëmeve në Qendrën Operative Emergjente 112 (QOE 112).

QOE 112 i përcjell këto raporte dhe kërkesa në nivel qendror, përkatësisht në Agjencinë për Menaxhimin Emergjent (AME) dhe strukturat përkatëse të nivelit shtetëror.

Komuna e Rahovecit dhe QOE 112 përdorin sisteme të standardizuara për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave financiare, përfshirë shpenzimet dhe detyrimet e krijuara gjatë situatave emergjente.

Të gjitha veprimet dhe operacionet e ndërmarra nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) dokumentohen dhe regjistrohen në mënyrë sistematike. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për raportim në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

DMSH-ja siguron raportim të rregullt, të saktë dhe në kohë gjatë gjithë fazave të menaxhimit emergjent.

Të gjitha dokumentet dhe raportet hartohen në përputhje me parimet e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME) dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

b. Financat

Menaxhimi financiar gjatë situatave emergjente realizohet në bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Financave të Komunës dhe strukturave të menaxhimit emergjent, me qëllim sigurimin e përdorimit efikas, transparent dhe të ligjshëm të fondeve publike.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Në këtë kuadër përfshihen:

- Identifikimi dhe alokimi i fondeve për emergjenca në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave;
- Përdorimi i fondeve rezervë komunale dhe burimeve të tjera të lejuara me ligj;
- Disbursimi i shpejtë i mjeteve financiare për nevojat emergjente, në koordinim me Drejtorinë e Financave;
- Menaxhimi i donacioneve dhe ndihmës financiare;
- Evidentimi, kontrolli dhe raportimi i shpenzimeve emergjente nga Drejtoria e Financave;
- Monitorimi i përdorimit të fondeve për të siguruar transparencë dhe efikasitet.

Në raste emergjente, procedurat standarde financiare dhe të prokurimit zbatohen në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave, përveç rasteve kur ligji lejon procedura të përshpejtuara për reagim më të shpejtë.

c. Logjistika - koordinimi i nevojave të paplotësuara:

Kur resurset komunale dhe ndihma reciproke janë të pamjaftueshme, QOE 112 koordinon sigurimin e ndihmës shtesë për plotësimin e nevojave.

Nëse kërkohet mbështetje shtesë:

- Kërkohet ndihmë nga komunat ose rajonet fqinje;
- Në emergjenca të mëdha ose fatkeqësi me ndikim të gjerë kërkohet mbështetje nga niveli qendror përmes Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (AME).

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e planit

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Komuna e Rahovecit është përgjegjëse për zhvillimin, miratimin dhe mirëmbajtjen e Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL), me qëllim sigurimin e një reagimi të koordinuar, efektiv dhe të qëndrueshëm ndaj emergjencave.

Rishikimi i planit

- Plan Operativ Emergjent Lokal rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse çdo katër (4) vjet;
- Përditësimi i planit bëhet së paku një herë në vit, ose më shpesh në rast të ndryshimeve në strukturat organizative, legjislacionin në fuqi, vlerësimin e rrezikut, resurset dhe kapacitetet emergjente;
- Versionet e përditësuara të planit miratohen nga organet kompetente komunale.
-

Projektimi i planit është një përpjekje gjithëpërfshirëse e komunitetit, duke përfshirë:

- Udhëheqja komunale

Ekspertë të fushave përkatëse, që kontribuojnë në:

- Analizën dhe vlerësimin e rreziqeve;
- Planifikimin e evakuimit dhe strehimit;
- Menaxhimin emergjent;
- Masat e zbutjes së rrezikut;
- Rimëkëmbjen dhe gatishmërinë emergjente;
- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Shembuj të pjesëmarrësve të planit:

Përfaqësuesit e grupeve të brendshme:

- Drejtoria e Financave;
- Drejtoria për Shërbime Publike;
- Drejtoria e Administratës;
- Drejtoria e Shëndetësisë;
- Drejtoria e Arsimit;
- Drejtoria e Bujqësisë.

Përfaqësuesit e grupeve të jashtme

- Shërbimi i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit;
- Policia;
- Institucionet shëndetësore;
- Kryqi i Kuq;
- Sektori privat;
- Organizatat joqeveritare (OJQ) ;
- Tjetër.

Koordinatori\zyrtari i menaxhimit emergjent do ta plotësojë Planin e Operacioneve Emergjente Lokal çdo vit. **Koordinatori\zyrtari** do të koordinojë me secilën organizatë të resurseve emergjente dhe do të sigurojë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një kapaciteti të duhur të reagimit emergjent.

Është përgjegjësi e koordinatorit\zyrtarit të Menaxhimit Emergjent të siguroar, që plani është i testuar dhe ushtruar sipas orarit të paraparë.

Shembull i një orari të ushtrimeve:

Është e zakonshme që ushtrimet funksionale për disa pjesë të planit planifikohen të mbahen sipas nevojës dhe resurseve komunale apo nivelit qendror\ AME; ushtrimet e tipit në tavolinë mbahen çdo viti; ushtrimet në shkallë të gjerë mbahen sipas resurseve komunale apo sipas ofrimit nga niveli qendror\AME.

Koordinatori\zyrtari emergjent është përgjegjës për mirëmbajtjen e orarit dhe do të sigurojë që resurset e nevojshme të jenë në dispozicion t'i kryejë këto aktivitete.

Pas çdo stërvitjeje, ushtrimi apo ngjarjeje aktuale, do të zhvillohet një diskutim i vlerësues dhe/apo analizë pas veprimit (APV). Çdo analizë e pasveprimit do të inkorporohet në plan me rastin e plotësimit të tij.

Plani Operativ Emergjent Lokal

I. Trajnimi dhe ushtrimet

Autoriteti i trajnimeve

- Personeli i trajnuar dhe i kualifikuar është thelbësor për zbatimin efektiv të planeve operative emergjente lokale (POEL) dhe nënplaneve komunale;
- Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim siguron që i gjithë personeli reagues të ketë kuptim të plotë të përgjegjësi të tij, rolet dhe përgjegjësitë të jenë të koordinuara me komponentët e tjerë të POEL-it;
- Personeli të pajiset me trajnimet e nevojshme për kryerjen efektive të detyrave;
- DMSH-ja dhe komuna zhvillojnë dhe mirëmbajnë një program gjithëpërfshirës trajnimor dhe ushtrimesh, përfshirë:
 - Trajnime të përgjithshme dhe kryesore (që mund të organizohet nga AME-ja);
 - Programe të vazhdueshme për ruajtjen e gatishmërisë emergjente (duke ruajtur dhe zhvilluar kapacitetet ekzistuese të NJPZSH-së).

a. Zhvillimi i trajnimeve

- Trajnimet bazohen në udhëzimet qendrore dhe mund të ofrohen nga:
 - Stafi dhe zyrtarët e komunës (në rast që ka kapacitete komunale për trajnimin e stafit, që nënkupton në rast se dikush nga komuna, paraprakisht është trajnuar për këto fusha nga AM-ja);
 - Agjencia për Menaxhimin Emergjent (AME);
 - Sektori privat dhe ushtria;
 - Organizatat dhe grupet vullnetare të trajnuara.

Të gjitha trajnimet dhe ushtrimet dokumentohen në mënyrë sistematike dhe regjistrohen për nevojat dhe pjesëmarrjen e personelit emergjent.

b. Ushtrimet

- Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim planifikon dhe zhvillon ushtrime në tavolinë sipas nevojës dhe mundësi.
- Ushtrimet synojnë:
 - Testimin e Planit Operativ Emergjent Lokal dhe të nënplaneve;
 - Trajnimin e zyrtarëve, stafit të reagimit emergjent dhe punonjësve të komunës;
 - Përmirësimin e organizimit të reagimit dhe të kapacitetit të përgjithshëm të komunës.
- Pjesëmarrësit e inkurajuar përfshijnë grupet gjysmëpublike, vullnetarët dhe agjencitë lokale.
- Mangësitë e identifikuar adresohen menjëherë pas ushtrimeve.

c. Kërkesat për ushtrime

Të sigurohen praktika dhe përvoja për testimin dhe vlerësimin e operacioneve për personat që kanë përgjegjësi në QOE, kurse KVME duhet të aktivizojë këtë plan të paktën çdo tre (3) apo katër (4) vjet në formën e një stërvitjeje (ushtrimi) emergjente.

d. Trajnimi - linjat e veprimit

Trajnimet për zyrtarët publikë:

a. Trajnimi i reagimit dhe rimëkëmbjes:

Programet e trajnimit do t'u ofrohen zyrtarëve komunalë, koordinatorit/zyrtarit të Menaxhimit Emergjent, personelit të QOE-së dhe personelit të shërbimeve emergjente (të policisë, zjarrfikjes dhe funksioneve mbështetëse emergjente), mbi politikat dhe procedurat për një reagim të koordinuar dhe sanimin e pasojave të një fatkeqësie të jashtëzakonshme. Programet e trajnimit ofrohen nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent të Kosovës, koordinuar me komunat dhe rajonet.

Plani Operativ Emergjent Lokal

b. Zhvillimi profesional:

Programet e trajnimit do t'i ofrohen komunës, stafit të OJQ-ve dhe sektorit privat për aftësimin në hartimin e planeve, zhvillimin e aftësive profesionale dhe çështjet e sigurisë në lidhje me përgatitjen komunale për emergjenca. Programet e trajnimit do të ofrohen nga AME-ja dhe do të koordinohen nga Qendra Operative për Emergjenca (QOE) dhe Komuna.

Vlerësimi i dëmeve dhe raportimi:

Trajnimet vjetore do të ofrojnë udhëzime mbi procedurat e raportimit dhe metodologjinë e vlerësimit të dëmeve, për personelin që do të angazhohet, në bashkëpunim me ekipet lokale të vlerësimit. Programet e trajnimit do të ofrohen nga AME-ja dhe do të koordinohen nga komuna.

Shërbimet emergjente dhe agjencitë e reagimit:

Ushtrimet përdoren për trajnim të zyrtarëve të zgjedhur dhe stafit emergjent lokal dhe rajonal, si dhe për personelin e FME-ve, sektorit privat dhe OJQ-ve.

Kërkesa për plan, mirëmbajtja dhe shpërndarja

a. Përgjegjësitë e DMSH-së

- **DMSH-ja** koordinon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e POEL-it;
- Komponentët e planit rishikohen dhe përditësohen **çdo vit** ose sipas nevojës;
- Anekset specifike mund të kërkojnë rishikim **vjetor** në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi;
- Rishikimi i përgjithshëm i planit bëhet çdo katër (4) vjet.
- Çdo përdorim i planit (ngjarje emergjente ose ushtrim) përfshin **rishikim për identifikimin e nevojave për ndryshime**.

b. Detyrueshmëria:

Ky plan miratohet dhe zbatohet në përputhje me rregulloren për metodologjinë e hartimit të planeve të reagimit emergjent dhe është i detyrueshëm për të gjitha strukturat përkatëse.

c. Zbatimi:

Plani aktivizohet dhe zbatohet me vendim të:

- Kryetarit të Komunës ose përfaqësuesit të autorizuar, në koordinim me DMSH-në dhe koordinatorin/zyrtarin komunal për Menaxhimin e Emergjencave.

d. Shpërndarja

- Plani shpërndahet sipas parimit “duhet të dini”.
- Versioni bazik mund të jetë më i qasshëm për institucionet përkatëse.
- Dokumentet që përmbajnë të dhëna sensitive nuk publikohen.

Përfshihen:

- Listat kontrolluese;
- Doracakët e resurseve;
- Planet specifike të incidenteve;

Plani Operativ Emergjent Lokal

- Regjistri i shpërndarjes mbahet nga koordinatori/zyrtari për Menaxhimin e Emergjencave;
- Të gjitha ndryshimet dokumentohen në regjistrin e ndryshimeve;
- Përdoret sistemi i kontrollit për shpërndarje dhe verifikim të dokumenteve.

Shtojca 1 – Fjalori i termave kryesorë

Kryqi i Kuq i Kosovës

Organizatë humanitare e udhëhequr nga vullnetarët, të cilët ofrojnë ndihmë për viktimat e fatkeqësive dhe ndihmojnë në parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave. Këtë e bën përmes shërbimeve të cilat janë në përputhje me ligjin dhe parimet e lëvizjes së Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

Spektori i Komandës

Një nga pesë fushat funksionale të sistemit të komandës së incidentit. Funksioni i komandës përfshin drejtimin, kontrollin dhe koordinimin e resurseve, përfshirë njerëzit dhe pajisjet, për arritjen e objektivave të reagimit emergjent.

Post-Komanda

Lokacion në të cilin zbatohen funksionet parësore të komandës: zakonisht të bashkëvendosura me bazën e incidentit. Te ne referohet gjithashtu edhe si Post-Komanda e Incidentit.

Menaxhimi gjithëpërfshirës i resurseve

Maksimalizon shfrytëzimin e resurseve të disponueshme, konsolidon resurset e përafërta dhe zvogëlon mbingarkesën në komunikim në operacionet e komandës së incidentit.

Koordinimi

Proces i analizimit sistematik të situatës; mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve relevante përkatëse lidhur me alternativat e mundshme për përzgjedhjen e kombinimit sa më efektiv të resurseve të disponueshme për arritjen e objektivave të caktuara.

Emergjencia

Çdo ngjarje (apo kërcënim), qoftë natyrore apo e shkaktuar nga faktori njeri, e cila rezulton apo mund të rezultojë në lëndime apo dëmtime substanciale në popullatë apo dëme ose humbje substanciale e të mirave materiale apo resurseve natyrore dhe që mund të përfshijë veprim qeveritar përtej asaj që është e autorizuar me ligjin ekzistues.

Dekontaminimi

Proces i sigurimit të njerëzve, objekteve dhe zonave nëpërmjet absorbimit, neutralizimit, zvogëlimit të efektit dëmtues apo zhvendosjes së materieve të rrezikshme.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Emergjencë/fatkeqësi/incident

Një ngjarje e cila kërkon reagim të menjëhershëm dhe të koordinuar përtej fushëveprimit të çdo agjencie apo shërbimi të vetëm dhe që paraqet rrezik për komunitetin apo hapësirën më të gjerë. Një emergjencë është zakonisht një ngjarje që mund të kontrollohet brenda fushëveprimit të kapaciteteve lokale, ndërsa emergjenca e madhe apo fatkeqësia zakonisht kërkon kapacitete përtej atyre që janë të disponueshme në nivel lokal.

Sistemi i alarmimit emergjent

Rrjet i stacioneve të shpërndarjes që ndërlidh institucionet e autorizuar nga Komisioni Qendror i Komunikimeve, për të operuar në mënyrë të kontrolluar për alarmimin dhe informimin e publikut mbi veprimet e nevojshme mbrojtëse, në rast të fatkeqësive apo situatave emergjente.

Qendra e operacioneve emergjente

Vendndodhje nga ku qeveria drejton dhe kontrollon operacionet e saj emergjente, ku informacioni lidhur me gjendjen e situatës emergjente grumbullohet, përpunohet të dhënat e situatës dhe realizohet koordinimi ndërmjet agjencive, nga ku kërkohet zyrtarisht asistencë nga jashtë.

Plani Lokal i Operacioneve Emergjente

Dokument që ofron reagime të planifikuara dhe të koordinuara ndaj situatave emergjente dhe fatkeqësive.

Menaxhimi Emergjent

Përgatitja për funksionet dhe zbatimin e tyre (të tjera nga funksionet për të cilat parësisht përgjegjëse janë forcat ushtarake) për të parandaluar, zvogëluar dhe trajtuar lëndimet dhe dëmet që rezultojnë nga fatkeqësitë natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri. Këto funksione përfshijnë zjarrfikjen, policinë, shëndetësinë, shpëtimin, paralajmërimin, inxhinierinë, komunikimin, evakuimin, menaxhimin e resurseve, mbrojtjen e bimëve, restaurimin e shërbimeve publike dhe funksionet e tjera të lidhura me ruajtjen e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së popullatës.

Funksioni i Mbështetjes Emergjente

Fushë funksionale e aktivitetit reagues e krijuar për lehtësimin e shpërndarjes së asistencës gjatë fazës së reagimit të menjëhershëm në rast fatkeqësie për shpëtimin e jetëve, mbrojtjen e të mirave materiale dhe shëndetit publik dhe ruajtjes së sigurisë publike.

Ushtrim

Një aktivitet i destinuar për mbështetjen e gatishmërisë emergjente, testimin ose vlerësimin e planeve të operacioneve emergjente, procedurave apo shërbimeve, trajnimin e personelit në detyrat e reagimit emergjent dhe demonstrimin e kapacitetit operacional. Ekzistojnë tri lloje të caktuara të ushtrimeve: ushtrime në tavolinë, funksionale dhe në shkallë të gjerë.

Evakuim

Ndihma për popullsinë në zhvendosjen nga zonat e rrezikuara në zona të sigurta.

Sistemi informativ gjeografik

Sistem kompjuterik i aftë për grumbullimin, renditjen, përpunimin dhe pasqyrimin e informacionit të referuar gjeografikisht, p.sh. të dhënat e përcaktuara sipas lokacionit të tyre.

Materiet e rrezikshme

Janë substanca apo materie të cilat mund të shkaktojnë rrezik të paparashikueshëm për shëndetin, pasurinë, ose për mjedisin, kur përdoren, transportohen, ruhen, ose asgjësohen. Këtu mund të përfshihen materiet që janë të ngurta, të lëngshme ose në gjendje të gaztë. Gjithashtu, materiet e rrezikshme mund të përfshijnë substanca

Plani Operativ Emergjent Lokal

toksike, djegëse dhe irrituese, eksplozive ose materie gërryese, si dhe materie radioaktive.

Sistemi i komandës së incidentit

Model për reagim ndaj fatkeqësive, i cili përdor terminologji të zakonshme, organizim të përshtatshëm, komunikim të integruar, strukturë komanduese të unifikuar, planifikim të veprimeve, hapësirë kontrolli të menaxhueshme, objekte të paracaktuara dhe menaxhim gjithëpërfshirës të resurseve. Në SKI ekzistojnë pesë funksione bazë: komanda, operacionet, logjistika, planifikimi dhe financat/administrata.

Komandanti i incidentit

Person përgjegjës për menaxhimin e të gjitha operacioneve të incidentit.

Raporti i vlerësimit të dëmeve fillestare

Raport që ofron informacion lidhur me dëmet e përgjithshme në pronat publike dhe private dhe shërben si bazë për shpalljen e gjendjes emergjente apo nevojës për asistencë.

Plani i Komunikimit të Integruar

Ky plan koordinon përdorimin e mjeteve të disponueshme të komunikimit dhe cakton frekuencat për funksionet e caktuara.

Emergjencë lokale

Gjendje e shpallur nga organi qeveritar lokal kur, sipas gjykimit të këtij trupi, ndodhja apo rreziku nga ndodhja e fatkeqësisë është apo kërcënon të jetë e tillë në përmasa dhe ashpërsi, e cila kërkon veprim të koordinuar të qeverisë lokale, për të parandaluar apo zbutur humbjen e jetëve, dëmtimin e pronave apo varfërimin. Vetëm Kryetari i Komunës, me kërkesë të trupit qeveritar, mund ta shpallë gjendjen emergjente.

Lehtësimi/zbutja

Aktivitete të cilat faktikisht eliminojnë apo zvogëlojnë gjasat e ndodhjes apo efekteve të një fatkeqësie. Në shembujt e masave lehtësuese/zbutëse përfshihen (nuk kufizohen vetëm me kaq): punimi i ligjeve apo rregulloreve për shfrytëzimin e tokave; përforsimi i standardeve të ndërtimit, rregulloreve dhe licencimit për prodhimin, përdorimin dhe deponimin e materieve të rrezikshme dhe inspektimi dhe zbatimi i këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

Marrëveshje për ndihmë reciproke

Marrëveshje me shkrim midis agjencive dhe/ose juridiksioneve në të cilën ata pajtohen të ndihmojnë njëri-tjetrin, me kërkesë të njëres palë, duke dërguar personel dhe/apo pajisje në një situatë emergjente.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Agjenci qendrore që ofron informacione për popullatën lidhur me motin dhe gjatë emergjencave të shkaktuara nga moti, zyrtarët shtetërorë dhe lokalë të menaxhimit emergjent.

Gatishmëria

Hartimi i planeve për të siguruar reagim efikas dhe efektiv ndaj një fatkeqësie apo emergjence. Aktivitetet e gatishmërisë janë të destinuara për të ndihmuar shpëtimin e jetëve dhe zvogëlimin e dëmeve duke i përgatitur njerëzit të reagojnë si duhet kur një emergjencë është e pashmangshme. Gatishmëria, gjithashtu, përfshin trajnimet, ushtrimet dhe ngritjen e resurseve të domosdoshme për arritjen e gatishmërisë për të gjitha rreziqet.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Shpallja presidenciale

Shpallja presidenciale liron burimet e ndryshme të asistencës nga qeveria qendrore bazuar në natyrën e kërkesës nga Kryetari i Komunës, vlerësimin të situatës nga AME-ja (raporti i situatës) dhe rekomandimi i AME-së të Ministri i Punëve të Brendshme si koordinator nacional për menaxhimin e incidenteve me karakter kombëtar. Shpallja bëhet sipas kushtetutës së Republikës së Kosovës nga kryetari i shtetit.

Agjencia parësore

Përderisa një numër i agjencive lokale do të kryejë një numër të detyrave të ndryshme gjatë fatkeqësisë, në shumicën e rasteve vetëm një prej tyre do të jetë "Agjenci parësore". Agjencitë parësore do të jenë përgjegjëse për planifikimin e hollësishëm, testimin dhe vlerësimin e funksioneve të tyre përkatëse të mbështetjes emergjente. Drejtori i agjencisë parësore do të shërbejë si këshilltar kryesor për Kryetarin e Komunës gjatë fazës së reagimit dhe rimëkëmbjes. Për më tepër, drejtori i agjencisë parësore duhet të sigurojë që operacionet esenciale të agjencisë së tij do të vazhdojnë, përveç nëse ndryshe vendoset nga Kryetari i Komunës apo i autorizuari i tij.

Qendra Operative Emergjente 112

Qendra lehtëson komunikimin dhe koordinimin midis autoriteteve lokale, rajonale dhe qendrore për të siguruar një reagim efektiv dhe koherent ndaj emergjencave dhe incidenteve rajonale.

Raport situatë

Raport i cili plotësohet në fund të çdo dite operative të qendrës operative emergjente lokale dhe i cili i siguron rajonit një përmbledhje zyrtare të gjendjes së emergjencës dhe reagimit emergjent lokal. Kopja e raportit duhet të dorëzohet në QOE-në rajonale përmes faksit apo në Departamentin e Menaxhimit Emergjent përmes web-faqes së tij.

Harku i kontrollit

Harku i kontrollit është numri i vartësve të cilët mund të mbikëqyrë në mënyrë efektive një mbikëqyrës. Udhëzimet për një hark të dëshirueshëm të kontrollit rekomandojnë tre deri në shtatë persona. Numri optimal i vartësve është pesë për një mbikëqyrës.

Gjendja emergjente

Gjendje e shpallur nga Presidenti kur, sipas gjykimit të tij, një fatkeqësi aktuale apo kërcënuese në çdo pjesë të shtetit është e përmasave dhe ashpërsisë së tillë që kërkon asistencë nga shteti për plotësimin e përpjekjeve lokale për parandalimin ose lehtësimin e humbjeve në jetë dhe dëmeve në pronë.

Komanda e bashkuar

Përgjegjësi e ndarë për menaxhimin e përgjithshëm të incidentit si rezultat i incidentit shumëjuridiksional apo shumëagjencor. Në rastet e prioriteteve dhe qëllimeve kontradiktore, apo ku resurset janë të pakta, duhet të ketë linjë të qartë autoriteti për vendimmarrje. Agjencitë kontribuojnë në komandën e bashkuar duke përcaktuar qëllime dhe objektiva të përgjithshme, duke planifikuar së bashku aktivitetet taktike, duke kryer operacione të integruara taktike dhe duke ngritur në maksimum shfrytëzimin e të gjitha resurseve të caktuara me detyrë.

Armët e shkatërrimit në masë

Çdo eksploziv, ndezës apo gaz helmues, bombë, granatë, raketë me shtytës të mbushur me më shumë se 113 gramë, apo predhë me ndezës të mbushur me më shumë se 7,09 gramë, si dhe mina apo pajisje shpërthyesë të ngjashme me to, ose çdo armë e cila është e destinuar për të lëshuar rreze apo rrezatim në nivele të rrezikshme për jetën e njeriut.

Plani Operativ Emergjent Lokal

Shtojca 2 – Lista e shkurtesave

POEL	Plani Operativ Emergjent Lokal
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar
MK	Marrëdhëniet me Komunitetin
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
QRF	Qendra për Rimëkëmbje nga Fatkeqësia
DMSH	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
ME	Ministria e Ekonomisë
MRF	Menaxheri për Rimëkëmbje nga Fatkeqësia
SAE	Sistemi i Alarmimit Emergjent
QOE	Qendra Operative Emergjente
KI	Komandanti i Incidentit
PKI	Post-Komanda e Incidentit
ZPF	Zyra e Përbashkët Fushore
FME	Funksion Mbështetës Emergjent
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SIME	Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent
AMA	Agjencia për Mbrojtjen e Ambientit
ERE- A	Ekipi i Reagimit Emergjent – Elementi Avancues
ShShKB	Shërbimi i Inspektimit të Shëndetit të Kafshëve dhe Bimëve
EKRE	Ekipet e Komunitetit për Reagim Emergjent
AME	Agjencia për Menaxhimin Emergjent
SKI	Sistemi i Komandës së Incidentit
QBI	Qendra e Bashkuar Informative
K\ZME	Koordinatori\Zyrtari për Menaxhimin Emergjent
ZBF	Zyra e Bashkuar Fushore
MACC	Qendra për Koordinim të Shumagjencive
MiM	Memorandum i Marrëveshjes
MeM	Marrëveshje e Mirëkuptimit
SKP	Sistemi Kombëtar i Paralajmërimit
ZKKI	Zyra Komunale për Komunikim dhe Informim
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
OJQ	Organizatë Joqeveritare
KKK	Kryqi i Kuq i Kosovës
SKMI	Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Incidenteve
PRK	Plani i Reagimit Kombëtar
SHMK	Shërbimi Meteorologjik Kombëtar
VPD	Vlerësimi Preliminar i Dëmeve
ZIP	Zyrtari për Informim Publik
PeK	Pikë e Kontaktit
KSH	Kërkimi dhe Shpëtimi
PSO	Procedurat Standarde Operative
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
OVAF	Organizatat Vullnetare Aktive në Fatkeqësi
AShM	Armët e Shkatërrimit në Masë

Plani Operativ Emergjent Lokal

Shtojca 3 – Autoriteti dhe referencat

Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera
 Ligji Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent
 Ligji Nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri
 Ligji Nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim
 Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent (SIME-2010)
 Plani i Reagimit Kombëtar (PRK-2023)
 Strategjia Shtetërore për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2016
 Rregullorja Nr. 08/2013 për Përmbytjen dhe Procedurat e Hartimit të Planeve të Reagimit Emergjent
 Vlerësimi i Rreziqeve në Nivel Qendror 2016
 Vlerësimi i Rreziqeve në Nivel Lokal 2023

Shtojca 4 – Matrica e përgjegjësi

Agjencia	FME # 1 Transporti	FME # 2 Kommunikimi	FME # 3 Punët publike	FME # 4 Zjarrfikja	FME # 5 Menaxhimi	FME # 6 Kujdesi masiv	FME # 7 Mbështetja e resurseve	FME # 8 Shëndeti dhe miekësia	FME # 9 Kërkimi dhe shpëtimi	FME # 10 Materiet e rrezikshme	FME # 11 Resurset bujqësore dhe natyrore	FME # 12 Energjia	FME # 13 Siguria publike	FME # 14 Rimëkëmbja Afat- gjatë	FM #15 Marrëdhëniet me jashtë
Menaxhimi emergjent	t														
Zjarrfikja				t											
Shërbimi emergjent mjekësor								t							
Zbatimi i ligjit													t		
Punët publike			t												
Planifikimi hapësinor													t		
Komuna/qeveria	t	t	t	t	t	t	t	t	t	t	t		t	t	t
Kryqi i Kuq						t			t					t	
Teknologjia informative	t														
Shërbimet sociale														t	
Financat														t	
Transporti	t														

Plani Operativ Emergjent Lokal

Shkollat publike					t									
Bordi i shërbimeve të komunitetit					t									
Autoriteti i ujërave										t				
Prokurori publik në nivelin lokal											t			
Marrëdhëniet me publikun		t												
OVAF					t		t	t					t	t
Task-forca lokale për rimëkëmbje													t	

Shtojca 5 – Bartja e autoritetit

Vazhdimësia e qeverisjes është thelbësore për menaxhimin efektiv të emergjencave dhe për zbatimin e pandërprerë të operacioneve të reagimit. Për të siguruar funksionimin e strukturave komunale në çdo rrethanë, në rast të mungesës, paaftësisë për veprim ose pamundësisë së komunikimit të zyrtarit përgjegjës, autoriteti dhe përgjegjësitë barten te personi pasues sipas renditjes së përcaktuar më poshtë. Bartja e autoritetit realizohet nga niveli më i lartë drejt nivelit më të ulët.

Bordi i drejtorëve të Komunës

1. Kryetari i Komunës;
2. Nënkryetari i Komunës;
3. Shefi i Kabinetit të kryetarit;
4. Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim;
5. Drejtori për Shërbime Publike;
6. Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
7. Drejtori për Buxhet dhe Financa;
8. Drejtori për Arsim;
9. Drejtori për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit;
10. Drejtori për Punë Inspektuese;
11. Drejtori për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm;
12. Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
13. Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë;
14. Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport;

Qendra Operative e Emergjente (QOE)

Në përputhje me parimet e menaxhimit të emergjencave dhe sistemit të komandimit të incidenteve, bartja e autoritetit brenda Qendrës Operative Emergjente bëhet sipas këtij rendi:

1. Udhëheqësi i QKME-së (Kryetari i Komunës apo personi i autorizuar prej tij);
2. Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim;
3. Koordinator / zyrtari për menaxhimin e emergjencave

Plani Operativ Emergjent Lokal

4. Komandanti i incidentit (kur emërohet);
5. Zyrtari për informim publik.

Institucionet pjesëmarrëse në QOE

- Policia e Kosovës;
- Shërbimi i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit;
- Shërbimet Shëndetësore;
- FSK (sipas nevojës);
- Kryqi i Kuq;
- Ndërmarrjet publike;
- Institucionet e tjera mbështetëse.

Shtojca 6 – Zhvendosja e qeverisë komunale

Në rast se objekti aktual i administratës komunale të Komunës së Rahovecit bëhet i papërdorshëm ose i pasigurt për shkak të një fatkeqësie natyrore, apo situatë emergjente, funksionet e qeverisjes komunale do të zhvendosen përkohësisht në lokacione alternative, me qëllim të garantimit të vazhdimësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

Lokacionet e parashikuara për këtë qëllim janë: lokacioni i parë: **Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Isa Boletini”** dhe lokacioni i dytë: **Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Sadedin Hajda”**.

Në varësi të natyrës, përmasave dhe rrethanave të emergjencës, zhvendosja mund të realizohet edhe në objekte të tjera publike ose private që ofrojnë kushtet e nevojshme për funksionimin e administratës komunale dhe për vazhdimësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Lokacionet e lartpërmendura plotësojnë kriteret e sigurisë dhe funksionalitetit, duke ofruar:

- **Siguri të mjaftueshme** për personelin komunal dhe qytetarët.
- **Hapësira të përshtatshme** për akomodimin e stafit dhe organizimin e aktiviteteve administrative.
- **Infrastrukturë funksionale**, përfshirë energjinë elektrike, ujin, sanitarinë dhe qasjen në internet.
- **Sisteme alternative të energjisë** (gjeneratorë) për sigurimin e funksioneve bazë.
- **Qasje të lehtë** në lokacionet e caktuara për personelin dhe qytetarët.

Shtojca 7 – Lista e shpërndarjes së POEL-it

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtimit
Koordinatori/Zyrtari i Menaxhimit Emergjent
Zyra e Komandantit të Stacionit Policor
Njësia e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit
Drejtoria e Pylltarisë - Agjencia e Pylltarisë, Rahovec
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra për Punë Sociale
Qendra e Komunikimit
Drejtoria komunale
Qendra Operative Emergjente 112
Zyra për Informim Publik, në nivelin komunal
Shërbimet komunale (rrymë, ujë, mbeturina)
Ekipi për vlerësimin e dëmeve
Kryqi i Kuq i Kosovës, dega në Rahovec
Bordi i drejtorëve
Këshilli i qytetit/fshatrave
Prokuroria në nivel komunal

Plani Operativ Emergjent Lokal

Shoqata e bizneseve, në nivel komunal

Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME)

Lista vazhdon sipas prioriteteve

Shtojca 8 – Dokumentet esenciale

Shënimet gjyqësore

Ruajtja e shënimeve esenciale për lokalitetin është përgjegjësi e sekretarit të gjykatës në nivel komunal. Të gjitha shënimet esenciale duhet të ruhen në dosje, të vendosura në zyrën e sekretarit të gjykatës komunale.

Në këto shënime përfshihen si në vijim:

- Dokumentacioni i pasurive të paluajtshme;
- Të dhënat penale;
- Testamentet;
- Regjistrat civilë;
- Dokumentacioni i gjykatave civile;
- Certifikatat e martesës.

Evakuimi i dokumenteve në raste emergjente do të bëhet vetëm me miratimin e sekretarit të gjykatës komunale. Ngarkimi dhe transporti i këtyre dokumenteve është përgjegjësi e Policisë së Kosovës.

Një kopje në mikrofilm ose në medium ruajtës (disk) e të dhënave për pasuritë e paluajtshme duhet të ruhet në një arkiv të sigurt.

Agjencitë/organizatat

Çdo agjenci \organizatë brenda strukturës së pushtetit lokal duhet të themelojë programe për mbrojtjen e dokumenteve dhe të të dhënave të veta.

Dokumentet e përcaktuara si esenciale për vijimin e funksioneve qeverisëse duhet të identifikohen dhe për to duhet të vendosen procedura mbrojtëse, si:

- ruajtja e kopjeve rezervë në një lokacion tjetër;
- përdorimi i objekteve të sigurta për deponimin e dokumenteve.

Gjithashtu, duhet të merren masa për sigurimin e operimit të vazhdueshëm të sistemeve të përpunimit automatik të të dhënave.

Shtojca 9 – Strehimi emergjent i popullsisë

Në kuadër të Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL), janë identifikuar disa lokacione që plotësojnë kushtet bazë për strehim emergjent të popullsisë:

- Palestra e Sporteve “Mizahir Isma” – kapacitet deri në rreth 1,000 persona;
- Shkolla e Mesme e Lartë “Xhelal Hajda – Toni” dhe Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale “Selajdin Mullaabazi” (Rahovec) – kapacitet i përbashkët mbi 1,000 persona;
- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Vëllezërit Frashëri” (Drenoc) – kapacitet mbi 500 persona;
- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Mustaf Ibishi” (Kramovik) – kapacitet mbi 700 persona;
- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Sadedin Hajda” (Rahovec) – kapacitet mbi 800 persona;
- Shkolla e Mesme e Lartë “Ukshin Hoti” (Krushë e Madhe) – kapacitet mbi 1,000 persona.

Kapaciteti i përgjithshëm i këtyre objekteve vlerësohet të jetë mbi **5,000 persona**.

Objektet e lartpërmendura përgjithësisht plotësojnë kushtet bazë për strehim emergjent, duke përfshirë:

- furnizim me ujë të pijshëm;
- energji elektrike (përfshirë gjeneratorë rezervë);

Plani Operativ Emergjent Lokal

- hapësira për përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit;
- kushte sanitare;
- qasje për personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë situatave emergjente, menaxhimi fillestar i këtyre lokacioneve realizohet nga drejtorët e institucioneve përkatëse, në koordinim me Drejtorinë Komunale për Mbrojtje dhe Shpëtim (DKMSh) dhe strukturat e FME #6 (Kujdesi masiv dhe strehimi), në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe organizata të tjera mbështetëse.

Vëmendje e veçantë u kushtohet grupeve të cënueshme, përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët.

Komuna e Rahovecit, sipas nevojës dhe rrethanave të krijuara, mund të identifikojë dhe aktivizojë edhe objekte të tjera që plotësojnë kriteret për strehim emergjent.

Shtojca 10 – Kapacitetet e Njesisë së Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

Kapacitetet e Njesisë së Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Komunën e Rahovecit			
Nr.	Pajisjet / kapacitetet	Sasia	Kapaciteti / përshkrimi
1.	Personeli i zjarrfikësve	18 pjesëtarë	Të përgatitur profesionalisht
2.	Automjet (tanker)	1	3000 litra.
3.	Automjet (sulmues)	1	2000 litra.
4.	Automjet (malor)	1	1000 litra.
5.	Automjet (sulmues)	1	1800 litra.
6.	Automjet taktik (xhip toyota) me pajisje për aksidente në komunikacion	1	1 gjenerator për gërrshërë, 1 palë gërrshërë për prerje, 1 shtytëse për hapje (variant i madh dhe i vogël), 1 gërrshërë për hapje, 1 gërrshërë mekanike dhe prerëse mekanike
7.	Automjet taktik (xhip toyota)	1	
8.	Pompa shpine për shuarje të zjarrit	15	20 lit.
9.	Litar shpëtimi	2	30 m
10.	Hidrantë / çelësa hidrantë	4	
11.	Pompë uji (goldon)	1	
12.	Pompë thithëse	2	Kapacitet 300 l/min
13.	Aparate të frymëmarrjes	20	
14.	Çanta/kuti të ndihmës së parë	2	
15.	Sharrë motorike	3	
16.	Pistoleta për shkumë	4	
17.	Përzierës me shkumë	2	
18.	Pistoleta uji	6	
19.	Tub për përzierje të shkumës	2	1.5m
20.	Jastëk i ndihmës së parë	1	
21.	Shkallë lëvizëse 5 m	2	Dypalëshe
22.	Rrip (kabllo) për tërheqje të automjetit	1	
23.	Sinjalizues (kona)	3	
24.	Shkallë të larta 10 m	1	10 m

Plani Operativ Emergjent Lokal

25.	Tuba për thithje të ujit Ø 120	2	4 m
26.	Tuba Ø 75 1.5m	5	
27.	Tuba Ø 75	7	
28.	Tuba Ø 52	30	
29.	Tuba Ø 20	5	
30.	Fshesa metalike për fikjen e zjarreve malore	25	
31.	Shpërndarës dyfish dhe trefish	5	
32.	Çelësa për tuba	5	
33.	Reduktorë 75/72 dhe 50/20	5	
34.	Pajisje për thithëse tymi	1	Kjo pajisje shërben për largimin e tymit nga objektet e ndryshme
35.	Hidrantë në qytet dhe në fshatra për furnizim me ujë të automjeteve të zjarrfikësve	4	Në stacionin e zjarrfikësve dhe në tri lagje të Rahovecit, si dhe në fshatrat Krushë e Madhe, Ratkoc, Çifllak dhe në Xërxë – objekti/depoja e KRU-Gjakova.
36.	Burime alternative për furnizim me ujë të automjeteve të Zjarrfikësve	8	Vrella në Rahovec, Opterushë, Zoqisht dhe Hoçë e Madhe.

Njësia e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Komunën e Rahovecit ka kapacitete bazike për reagim fillestar ndaj zjarreve, aksidenteve dhe emergjencave të tjera. Megjithatë, në raste të incidenteve me përmasa të mëdha ose emergjencave të kombinuara, mund të kërkohet mbështetje shtesë nga niveli rajonal ose qendror.

Shtojca 11 – Resurset emergjente, shëndetësore në komunën e Rahovecit

Resurset emergjente: personeli, automjetet dhe pajisjet për ekipin mjekësor emergjent

Nr.	Automjetet dhe pajisjet e ekipit emergjent në kuadër të/QKMF-së	Sasia
1.	Autoambulanca të pajisura plotësisht	5
2.	Ekiye mjekësore emergjente	1 ekip në ndërrimin e parë dhe 2 ekiye në ndërrimin e dytë
3.	Shtretër në emergjencë	6
4.	Defibrilatorë (manualë dhe automatikë)	2 manualë dhe 2 automatikë
5.	Aparate EKG	2
6.	Aparat rëntgen	1
7.	Mamograf	1
8.	Pajisje për intubim	2
9.	Shoferë emergjentë / infermierë	8
10.	Çanta me pajisje për reagim emergjent	5
11.	Pajisje për imobilizim (qafore dhe splinta)	1 qafore 6, splinta
12.	Automjet për bartje të bocave me oksigjen (4 boca)	1
13.	Barela portative	4
14.	Njësi për ndihmë psikosociale	0
15.	Gjeneratorë elektrikë mobilë	0
16.	Pajisje për oksigjenoterapi (bombola, rregullatorë, maska, kanula nazale)	2 në objektin e urgjencës dhe 5 në autoambulanca
17.	Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF)	7 QMF dhe 7 AMF me 9 mjekë dhe 25 infermierë

Plani Operativ Emergjent Lokal

Kapacitetet ekzistuese mundësojnë reagim fillestar dhe menaxhim të situatave emergjente në nivel lokal. Megjithatë, në raste të incidenteve me përmasa të mëdha ose emergjencave të kombinuara, këto kapacitete mund të jenë të kufizuara.

Shtojca 12 – Kapacitetet e Degës së Kryqit të Kuq të Kosovës në Rahovec

Nr.	Kapacitetet e Kryqit të Kuq	
1.	Instrukturë të licencuar për Ndhmën e Parë.	3 aktiv
2.	Vullnetarë të trajnuar për përkrahje psikosociale	1 nga dega e Rahovecit dhe 2 nga degë të tjera
3.	Vullnetarë të trajnuar për reagim në fatkeqësi dhe menaxhim kampi	2
4.	Barela për bartjen e të lënduarve	2
5.	Çanta shpinore për ndihmë të parë	1
6.	Pajisje për punë (tenda për nevoja emergjente, gjenerator 3 kw)	5 tenda, 1 gjenerator
7.	Shofer emergjent	Secili prej vullnetarëve të paraqitur mund të drejtojë automjetin në rast nevojë
8.	Vullnetarë aktivë dhe të trajnuar në fusha të ndryshme, si në: ndihmë të parë, përkrahje psikosociale, menaxhim të kampit, reagim në fatkeqësi etj.	Ka vullnetarë të trajnuar, po aktualisht nuk janë aktivë Megjithatë, kemi 3 vullnetarë që janë të gatshëm të reagojnë në rast fatkeqësie
9.	Automjete	1 automjet tipi “landcruiver”
10.	Pajisje dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me kapacitetet e Kryqit të Kuq	Depo logjistike me sipërfaqe rreth 100 m ² Për ruajtjen e ndihmave dhe pajisjeve
Dega e Kryqit të Kuq në Rahovec bashkëpunon me DKMSh-në, QOE-në dhe institucionet e tjera gjatë reagimit emergjent.		